

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5738
E premte, 29 mars 2019
çmimi 0.40 €

Komunat mbesin pa certifikata



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

AFORIZMA PËR POLITIKANËT QË DËGJOJNË



F. 11
Prof. Lisen BASHKURTI



KUJTOHET MASAKRA E IZBICËS, KOSOVA KËRKON DREJTËSI PËR KRIMET QË KA BËRË SERBIA F. 6

VESELI: INSTITUCIONET DUHET TË PASTROHEN NGA ABUZUESIT F. 5

EKONOMI

AMBASADA E BRITANISË TËRHIQET NGA REKRUTIMI I POZITËS SË KRYESUESIT TË BORDIT TË ZRRE-së F. 8

PËRMBYLLET PROGRAMI PËR BURSA 'GRATË NË ENERGJI' F. 9

SPORT

FFK-ja NDAN PENSION PËR BASHKËSHORTEN E FADIL VOKRRIT F. 13



Parlamenti Evropian rikonfirmon heqjen e vizave për Kosovën



Me 331 vota për, Parlamenti Evropian ka votuar të enjten pozitivisht një raport të përgatitur nga raportuesja për Kosovën, Tanja Fajon, i cili kishte të bënte me liberalizimin e vizave. Ky votim ka qenë pjesë e një hapi ligjor që të vazhdohet mandati i këtij procesi edhe në kohën e tranzicionit, pasi zgjedhjet në BE do të mbahen në muajin maj. Liderët institucionalë të Kosovës e kanë mirëpritur votimin pozitiv të Parlamentit Evropian, ndërsa raportuesja për Kosovën, Tanja Fajon, ka ftuar edhe një herë Këshillin Evropian ta bëjë punën e vet në këtë proces

PAS NJË VITI BLOKADË, KQZ-ja BËHET FUNKSIONALE

Pas dymbëdhjetë muajve bllokadë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka arritur të bëhet funksional. Zhblllokimi i KQZ-së është bërë të enjten me emërimin e tetë anëtarëve të rinj. Megjithatë, ky institucion ende nuk është kompletuar tërësisht, meqenëse mungojnë dy përfaqësuesit e koalicionit PAN. Sidoqoftë, pas emërimit të anëtarëve të rinj, KQZ-ja ka mbajtur mbledhjen e parë në të cilën është marrë vendimi për zëvendësimin e



deputetit të Kuvendit të Kosovës, Nezir Çoçaj me Rafet Ramën, si dhe është marrë vendimi për zëvendësimin e këshilltarëve nëpër kuvendet komunale



Kuvendi kërkon nga SBASHK-u ta gjejë mënyrën e kompensimit të orëve të humbura

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Shumica e qytetarëve serbë e konsiderojnë Kosovën të humbur

Të gjeturat e një hulumtimi që ka realizuar Instituti për Çështje Evropiane në Beograd tregojnë se shumica e qytetarëve serbë mendojnë se Serbia e ka humbur Kosovën dhe nuk mund ta kthejë sërish sovranitetin e saj dhe se respondentët besojnë se Qeveria serbe nuk do ta njohë Kosovën dhe nëse do të organizohej ndonjë referendum i mundshëm, do të votonin kundër njohjes së saj



BEGRAD, 28 MARS - Shumica e qytetarëve serbë mendojnë se Serbia e ka humbur Kosovën dhe nuk mund ta kthejë sërish sovranitetin e saj, është thënë në gjeturat e një hulumtimi që ka realizuar Instituti për Çështje Evropiane në Beograd. Respondentët besojnë se Qeveria serbe nuk do ta njohë Kosovën dhe nëse do të organizohej ndonjë referendum i mundshëm, do të votonin kundër njohjes së saj. Sipas të dhënave të publikuara, 47 për qind e të intervistuarve kanë thënë se Kosova është e humbur, 41 për qind mendojnë të kundërtën, ndërsa 12 për

qind nuk kanë pasur përgjigje. Qytetarët serbë që mendojnë se Serbia e ka humbur Kosovën, sipas këtij hulumtimi, janë të moshës ndërmjet 30 dhe 60 vjeçare, me nivel arsimimi të mesëm apo të lartë, si dhe jetojnë kryesisht në të gjitha rajonet e Serbisë, përjashtuar pjesën jugore dhe lindore të vendit, ka njoftuar rfe. Në pyetjen se si do të votonin nëse nesër organizohet një referendum për çështjen e pavarësisë së Kosovës, 74.5 për qind kanë thënë se do të votonin kundër. Në të mirë të pavarësisë do të votonin 6.2

për qind. Në hulumtim janë përfshirë 1 207 qytetarë, i cili është realizuar në periudhën ndërmjet 8 dhe 14 marsit të këtij viti. Qytetarët në përgjithësi janë përgjigjur se nuk kanë marrë pjesë në dialogun e brendshëm për Kosovën dhe ata nuk e dinë se çfarë nënkuptohet me përcaktimin e kufijve ndër-

mjet Kosovës dhe Serbisë, mirëpo shumica kanë thënë se janë kundër këtij propozimi. Hulumtimi tregon se 57 për qind e qytetarëve nuk e dinë çfarë do të thotë ideja e përcaktimit të kufijve. Rreth 29 për qind me përcaktim të kufijve e nënkuptojnë ndarjen, përmes së cilës veriu i Kosovës do t'i takonte Serbisë, ndërsa

Lugina e Preshevës do të bashkohej me Kosovën. Sa i përket anëtarësimit të mundshëm të Serbisë në Bashkimin Evropian, 78 për qind e të anketuarve kanë thënë se nuk e mbështesin njohjen e pavarësisë së Kosovës në këmbim të anëtarësimit të shpejtë të Serbisë në bllokun evropian.

Opozita vazhdon presionin me protesta

TIRANË, 28 MARS - Partitë opozitare në Shqipëri, bashkë me mbështetësit e tyre, kanë marshuar nëpër rrugët e Tiranës, duke shënuar protestën e shtatë, që kërkon largimin e Qeverisë aktuale në krye me Edi Ramën.

Edhe pse u nis me tensione dhe përplasje mes protestuesve dhe forcave të Policisë së Shtetit, që kishin krijuar kordon rreth institucionit më të lartë shtetëror - Parlamentit, kjo protestë vazhdoi e qetë. Teksa protestuesit brohorisnin "Rama ik", brenda në Kuvend mbahej seanca plenare ku po botoheshin dy deputetë të rinj, të cilët kanë qenë në rend pritjeje në listat zgjedhore. Betimi i këtyre deputetëve vjen disa javë pasi ligjvënësit që kishin fituar mandatet, në formë "proteste dhe moslegjitimimi" të qeverisë, dogjën mandatet që kishin fituar në zgjedhjet e kaluara.



Protestuesit përgjatë protestimit të tyre, u spostuan te Ministria e Brendshme ku hodhën ngjyrë të zezë dhe kërkuan lirinë e personave të ndaluar në protestat e kaluara. Më pas, turma e njerëzve vazhdoi marshimin te selia e Partisë Demokratike, ku përfundoi protesta. Qeveria, në anën tjetër, ka cilësuar organizimin e protestave nga Lulzim Basha si "agjendë e Rusisë" në Ballkan, duke thënë

se ato kanë për qëllim vetëm destabilizimin e vendit dhe bllokimin e hapjes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Opozita që ka kaluar në mosbindje civile, tashmë që disa javë, ka marrë masa proteste kundër qeverisë dhe kërkon largimin e kryeministrit shqiptar, Edi Rama, si dhe krijimin e një qeverie të përkohshme që t'i organizojë zgjedhjet e parakohshme.

Kërkesat e porealizuara, studentët paralajmërojnë sërish protesta

TIRANË, 28 MARS - Këshillat studentorë të disa universiteteve në vend, me në krye Universitetin e Tiranës, por pa harruar atë "Aleksandër Moisiu" në Durrës, "Fan S. Noli" në Korçë, "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan, si dhe Mjekësia, Politekniku dhe ai Bujqësor i Kamzës, kanë dalë me një deklaratë zyrtare të enjten, ku shprehen se qeveria vërtet ka punuar me "Paktin për universitetin", por mbi 90 për qind e kërkesave ose nuk janë plotësuar, ose janë deformuar dhe plotësuar pak. Sipas asaj që thonë këshillat studentorë, kërkesa kryesore të tyre mbeten rrëzimi i menjëhershëm i Ligjit për Arsimin e Lartë, por edhe marrja me seriozitet e plotësimit të të gjitha kërkesave të tyre. Ndër to, përgjysmimi i tarifave të

studentëve duhej bërë në janar 2019, pikë që është plotësuar pjesërisht, vetëm për ciklin "Bachelor" dhe jo për "Master"-in; faqet e internetit që do të bënin transparencën e buxhetit të universiteteve nuk janë ngritur ende, edhe pse sipas Paktit duhej të bëheshin në janar të 2019-s; sikurse edhe pesha e votës së studentëve nuk është rritur ende, edhe pse duhej ndryshuar që në muajin e parë të vitit. Këshillat studentorë thonë se edhe shkarkimi i anëtarëve të bordeve të administrimit është bërë në mënyrë të pjesshme, ndërsa sa i përket kartës së studentit, ende asnjë hap nuk është bërë për të. Në përfundim, duke paralajmëruar protesta të tjera në mbështetje të kauzës së tyre, ata kërkojnë një takim urgjent me ministrin e Arsimit, Besa Shahini.



Atila Rexhepi jep dorëheqje nga posti i sekretarit të BDI-së?

SHKUP, 27 MARS - Burime të sigurta të Agjencisë së Lajmeve Zhurnal jozyrtarisht bëjnë me dije se sekretari i përgjithshëm i

Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Atila Rexhepi, në selinë e kësaj partie ka dorëzuar dorëheqjen nga posti i sekretarit

të përgjithshëm të BDI-së, i cili këtë post e mori para disa muajve. Siç mëson "Zhurnal" nga burime të sigurta, Rexhepi

dorëheqjen e deponoi më 7 mars në organet e partisë, por shkaqet për një veprim të tillë ende nuk dihen.

Emërohen anëtarët e rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së)

Pas një viti bllokadë, KQZ-ja bëhet funksionale

Pas dymbëdhjetë muajve bllokadë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka arritur të bëhet funksional. Zhblokimi i KQZ-së është bërë të enjten me emërimin e tetë anëtarëve të rinj. Megjithatë, ky institucion ende nuk është kompletuar tërësisht, meqenëse mungojnë dy përfaqësuesit e koalicionit PAN. Sidoqoftë, pas emërimit të anëtarëve të rinj, KQZ-ja ka mbajtur mbledhjen e parë në të cilën është marrë vendimi për zëvendësimin e deputetit të Kuvendit të Kosovës, Nezir Çoçaj me Rafet Ramën, si dhe është marrë vendimi për zëvendësimin e këshilltarëve nëpër kuvendet komunale



Lidhur me përfaqësimin në KQZ të enjten nuk janë deklaruar as përfaqësuesit e AAK-së dhe të Nismës.

Emërimi i anëtarëve të KQZ-së është bërë tri ditë pas reagimit të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë lidhur me bllokimin e KQZ-së për më shumë se një vit.

Përveç partive të koalicionit qeverisës, hise në KQZ është duke kërkuar edhe subjekti tjetër opozitar, Partia Socialdemokrate (PSD), që është formuar pas ndarjes nga Lëvizja Vetëvendosje.

Ndërsa kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka bërë me dije se pas emërimeve të anëtarëve të rinj

KQZ-ja është bërë funksionale. "Me këto emërimet KQZ-ja funksionalizohet dhe në ditët në vijim do t'i përfundojmë të gjitha çështjet që kanë mbetur pa u përfunduar", ka deklaruar Daka. Përveç PSD-së, edhe Aleanca Kosova e Re (AKR) ka kërkuar përfaqësim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

Prishtinë, 28 mars - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka emëruar të enjten tetë anëtarët e rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Anëtarët e rinj të KQZ-së janë betuar se do t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të ndershme, besnike, të paanshme, profesionale dhe të ndërgjegjshme.

Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) në KQZ do ta përfaqësojnë Sami Hamiti dhe Florian Dushi, Lëvizjen Vetëvendosje Adnan Rrustemi dhe Nazlie Bala, kurse partitë minoritare do të përfaqësohen nga Alfred Kinolli, Qemail Kurtishi, Ercan Shpat dhe Stevan Veselinoviq. Por në KQZ mungojnë dy përfaqësuesit e koalicionit qeverisës meqë partitë në pushtet kërkojnë të përfaqësohen në këtë institucion si parti politike dhe jo si koalicion, ngaqë përfaqësimi si koalicion e privon njërin prej tyre që të sigurojë ulëse në KQZ.

Ndonëse pjesë e koalicionit janë tri partitë më të mëdha, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nisma Socialdemokrate, ato në KQZ do t'i kenë vetëm dy vende. Këto parti në zgjedhjet e fundit parlamentare patën kanë garuar si

koalicioni PAN, prandaj edhe presidenti është nisur nga ky parim, duke u ndarë atyre së bashku dy vende në KQZ. Mirëpo për këtë çështje nuk ka dashur të deklarohet të enjten kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh edhe lideri i koalicionit qeverisës, Kadri Veseli, duke mos treguar arsyet pse partitë e koalicionit nuk i kanë dërguar emrat e tyre për dy vendet e mbetura bosh. Megjithatë, Veseli ka thënë se nuk sheh lëkundje të koalicionit për shkak të garës rreth përfaqësimit në KQZ. "Koalicioni qeverisës gjithmonë lëkundet prej vetvetes. Kur i vjen koha edhe lëkundet. Por, besoj se ende është duke qëndruar", ka thënë Veseli.

KQZ-ja zëvendëson këshilltarët e kuvendeve komunale dhe miraton fondin për partitë parlamentare



Pas emërimit të tetë anëtarëve të rinj, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur të enjten mbledhjen e parë në përbërje të re të kryesuar nga kryetarja Valdete Daka. Në këtë mbledhje KQZ-ja ka marrë vendim për zëvendësimin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nezir Çoçaj, me kandidatin e radhës,

Rafet Rama. Po në këtë mbledhje është marrë vendimi edhe për zëvendësimin e këshilltarëve nëpër kuvendet komunale. Përbërja e re e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në mbledhjen e së enjtes ka miratuar edhe fondin prej 4 milionë e 200 mijë eurosh që u takon subjekteve parlamentare për vitin 2019.

Presidenti Thaçi dhe komandanti i KFOR-it flasin për gjendjen e sigurisë

PRISHTINË, 28 MARS (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të enjten ka takuar komandantin e KFOR-it, Lorenzo D'Addario, me të cilin ka biseduar për gjendjen e sigurisë në Kosovë. "KFOR-i mbetet institucioni më i besueshëm në Kosovë për të gjithë qytetarët e të gjitha

komuniteteve", u shpreh presidenti Thaçi. Ndërsa komandanti i KFOR-it, Lorenzo D'Addario, u shpreh i kënaqur me bashkëpunimin në mes të KFOR-it dhe institucioneve të Kosovës. Në këtë takim është konstatuar se gjendja e sigurisë është e mirë.



Parlamenti Evropian (PE) ka rikonfirmuar mandatin për liberalizimin e vizave për Kosovën

Parlamenti Evropian rikonfirmon heq



Me 331 vota për, Parlamenti Evropian ka votuar të enjten pozitivisht një raport të përgatitur nga raportuesja për Kosovën, Tanja Fajon, i cili kishte të bënte me liberalizimin e vizave. Ky votim ka qenë pjesë e një hapi ligjor që të vazhdohet mandati i këtij procesi edhe në kohën e tranzicionit, pasi zgjedhjet në BE do të mbahen në muajin maj. Liderët institucionalë të Kosovës e kanë mirëpritur votimin pozitiv të Parlamentit Evropian, ndërsa raportuesja për Kosovën, Tanja Fajon, ka ftuar edhe një herë Këshillin Evropian ta bëjë punën e tij në këtë proces

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 28 MARS - Parlamenti Evropian ka votuar të enjten për ta vazhduar mandatin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Ky votim ka qenë pjesë e një hapi ligjor, në mënyrë që të vazhdohet mandati i këtij procesi edhe në kohën e tranzicionit, pasi zgjedhjet në Bashkimin Evropian do të mbahen në muajin maj. Pas votimit, raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Tanja

Fajon, ka ftuar edhe një herë Këshillin Evropian ta bëjë punën e vet. "Shumica kanë votuar në të mirë të liberalizimit të vizave për Kosovën. I bëjmë thirrje Këshillit Evropian të veprojë tani", ka shkruar ajo në llogarinë e vet në "Twitter". Edhe liderët institucionalë të Kosovës kanë bërë me dije se ky vullnet i Parlamentit Evropian duhet të përmbillet me liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës. Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se nën lidhshirin e eurodeputetes Tanja Fajon, në

Parlamentin Evropian, me 331 vota për, u konfirmua për të dytën herë mandati për fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave për Kosovën. "Një vullnet kaq i fuqishëm politik, që buroi sot nga Parlamenti Evropian në Strasburg, rikonfirmon për të disatën herë se institucionet e Kosovës i kanë përmbushur të gjitha kushtet e parashtruara, siç e ka konfirmuar edhe Komisioni Evropian në Bruksel vitin e kaluar. Është tërësisht e padrejtë, frustruese dhe dekurajuese që qytetarëve të Kosovës vazhdon t'u mohohet

e drejta e fituar për lëvizje të lirë në Evropë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se në emër të institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës u bënë thirrje kryeqyteteve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që t'i japin drejtim dhe epilog çështjes së liberalizimit të vizave për Kosovën, siç ka thënë kryeministri, "si e drejtë e fituar dhe e pakontestueshme, tani kur bëhen shtatë vjet nga data kur na është dorëzuar udhërrëfyesi për vizat". Haradinaj ka thënë se Kosova vazhdon të mbetet e fokusuar në përkushtimin e saj për avancimin e rrugës drejt Bashkimit Evropian dhe u qëndron fuqishëm besnike vlerave dhe parimeve për të cilat jemi zotuar bashkë në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është treguar kritik të enjten ndaj BE-së. Ai ka thënë se Kosova

nuk ka rini për të humbur, as në Lindje e as në Perëndim. "Partnerët tanë të BE-së të mos i marrin të rinjtë tanë vetëm si punëtorë, por ta lejojnë liberalizimin e vizave. Nuk jemi as më të mirë, por as më të këqij se ju. Jemi evropianë, por fati historik na ka lënë mbrapa. Nuk është e drejtë e askujt të na thotë se jemi evropianë të rangut të dytë. Liberalizoni vizat dhe ne, po ashtu, do t'i marrim përgjegjësitë tona", është shprehur Veseli. Edhe zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka thënë se është koha t'i jepet fund izolimit paradoksal. "Është koha që edhe institucionet e tjera bashkëvendimmarrëse të Bashkimit Evropian ta respektojnë verdiktin e këtij tempulli të demokracisë evropiane. Në fakt, përmbushja e kriterëve nga ana e Republikës së Kosovës ka qenë përkushtimi ynë për t'u bërë pjesë e një komuniteti më të madh

jen e vizave për qytetarët e Kosovës

përcaktuara për liberalizimin e vizave. "Vullneti i demonstruar në Parlamentin Evropian duhet kulmojë me heqjen e vizave në një të ardhme sa më të afërt. Qytetarët tanë po mbahen padrejtësisht të izoluar dhe kjo padrejtësi duhet të përfundojë

sa më parë", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Procesi i liberalizimit të vizave ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian ka filluar në vitin 2012. Bashkimi Evropian i kishte vënë Kosovës

si detyrë të plotësojë 95 kriteret për ta marrë rekomandimin pozitiv për liberalizim të vizave nga Komisioni Evropian. Një rekomandim të tillë, Komisioni Evropian e ka bërë në korrik të vitit 2018, ndërkaq në shtator të po atij viti, Parlamenti Evropian

kishte votuar në favor të liberalizimit të vizave për Kosovën.

Në muajin dhjetor të vitit të kaluar, Këshilli i Ministrave nuk e vendosi fare në agjendën e takimit të tyre çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën.

Veseli: Institucionet duhet të pastrohen nga abuzuesit

PRISHTINË, 28 MARS (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka paralajmëruar masa drastike në luftën kundër korrupsionit dhe kriminit të organizuar. Në përmbyllje të projektit të mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe realizuar nga forcat italiane "Carabinieri" që kanë mbështetur Policinë e Kosovës në ngritjen e kapaciteteve në luftën kundër dukurive negative, Veseli ka thënë se Kosova ka shënuar përparim, por do të vazhdojë edhe më fuqishëm ta luftojë korrupsionin dhe kriminit e organizuar. Ai ka theksuar se në secilën matje të opinionit publik rezulton se qytetarët e Kosovës ndihen thellësisht të brengosur me korrupsionin, me nepotizmin dhe klientelizmin në institucionet

publike, ndërsa ka shtuar se ka ardhur koha që të veprohet kundër këtyre dukurive negative, pasojat e të cilave janë të shumëfishta.

Veseli ka thënë se institucionet e shtetit duhet të pastrohen nga abuzuesit. "Hajnat e kanë vendin në bankën e të akuzuarve, e jo në shtet. Individët me përgjegjësi zyrtare, që në vend të luftimit të kriminit të organizuar, kanë zgjedhur të bashkëpunojnë me të, ju them se nuk do të mund të vazhdojnë më tutje. Do t'i ndalim, kushdo qofshin ata, pavarësisht prej përkatësive partiake apo etnike", është shprehur kryeparlamentari Veseli.

Kreu i Kuvendit ka shtuar se qytetarët e këtij vendi nuk kanë luftuar për të krijuar një shtet që në mënyrë të

paligjshme favorizon disa, duke zvogëluar shanset për të tjerët. "Ne kemi zgjedhur të jetojmë në ekonominë e lirë të tregut dhe kjo nënkupton krijimin e një elite ekonomike, por kjo elitë duhet të zhvillohet nga sipërmarrja e ligjshme dhe prodhimi i sektorit privat, e jo përmes zhatjes së pasurisë publike, familjarizimit të posteve publike dhe keqpërdorimit të tyre. Duhet ta themi haptas: të korrup-tuarit janë aleatë në pasojat me Serbinë. Pse e them këtë? Dhe çka do të thotë 'aleatë në pasojat'? Nëse Serbia po përpiqet me të gjitha mjetet ta dëmtojë shtetësinë e Kosovës në planin ndërkombëtar, mentaliteti korruptiv është duke e dëmtuar integritetin e brendshëm të shtetit të Kosovës", ka thënë Veseli.

Në vazhdim të fjalës së tij, kryeparlamentari Veseli ka pohuar se Kosova ka dhënë shumë njerëz dhe ka bërë shumë sakrifica, prandaj askush nuk ka të drejtë të flasë në emër të shtetit dhe ta marrë shtetin me vete. Shteti, ka thënë Veseli, u takon vetëm qytetarëve. "Kosova nuk ka rini për të humbur, as në Lindje e as në Perëndim. Partnerët tanë të BE-së të mos i marrin të rinjtë tanë vetëm si punëtorë, por ta lejojnë liberalizimin e vizave. Nuk jemi as më të mirë, por as më të këqij se ju. Jemi evropianë, por fati historik na ka lënë mbrapa. Nuk është e drejtë e askujt të na thotë se jemi evropianë të rangut të dytë. Liberalizoni vizat dhe ne, po ashtu, do t'i marrim përgjegjësitë tona", ka deklaruar Veseli.

demokratik, familjes së vendeve demokratike. Liberalizoni vizat, lëvizja e lirë në Evropë është e drejtë themelore njerëzore. Mos na ndalni rritjen demokratike të vendit tonë të ri, jepni fund një izolimi paradoksal!", ka thënë Pacolli pas këtij vendimi pozitiv të Parlamentit Evropian.

Edhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka reaguar pas votimit pozitiv në Parlamentin Evropian për liberalizimin e vizave. "Raporti i Tanja Fajonit për liberalizimin e vizave, i votuar me 331 vota, është rikonfirmim i punës së institucioneve tona. Ne e kemi merituar liberalizimin, kemi kërkuar trajtim të barabartë me shtetet e deritashme aspirante për liberalizim. Përrjashtëmi ynë është shumë i padrejtë", ka thënë ministrja Hoxha.

Edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj e ka vlerësuar lajm të mirë që Parlamenti Evropian rikonfirmoi sërish me shumicë votash që Kosova tashmë i ka përmbushur të gjitha kriteret e



Kujtohet masakra e Izbicës, Kosova kërkon drejtësi për krimet që ka bërë Serbia

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 28 MARS - Nën përku-
jdesjen e presidentit të Kosovës të
enjtën, në 20-vjetorin e masakrës
së Izbicës, është mbajtur një
akademi përkujtimore. Në këtë
përvjetor presidenti Hashim
Thaçi ka kujtuar 147 të rënë nga
Izbica dhe vendbanimet përreth
saj. "Kujtojmë gjithë martirët dhe
viktimat e terrorit të shtetit të
Serbisë në vitet 1998 dhe 1999. I
kujtojmë ata që u vranë dhe u
masakruan vetëm pse ishin
shqiptarë. Njerëz të paarmatosur,
pleq, gra, burra, fëmijë, të rinj e të
reja që u vranë në vatrën dhe në
tokën e tyre gjithandej Kosovës",
është shprehur Thaçi, duke
shtuar se Kosova kurrë nuk do t'i
harrojë tragjeditë në Likoshan,
Çirez, Prekaz, Abri, Reçak, Celinë,
Krushë, Rezallë, Qyshk, Poklek,
Studime, Mejë dhe në shumë
vendbanime të tjera. "Shteti i
Serbisë bëri gjenocid dhe
spastrim etnik në Kosovë. Dëboi
qindra mijë shqiptarë jashtë
Kosovës. Dogji dhe plaçkiti

pasurinë e qytetarëve tanë.
Asnjëherë nuk do të harrohen
përmasat e krimeve të Serbisë
mbi popullatën e Kosovës", ka
theksuar Thaçi.
Ai ka thënë se Kosova sivjet
shënon njëzetvjetorin e çlirimit
dhe, sipas tij, kjo ditë nuk do të
vinte pa luftën e drejtë të
Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
"Nuk do të vinte pa sakrificën
dhe gjakun e dy mijë
dëshmorëve dhe mijëra
martirëve. Lufta e drejtë e popullit
tonë u përkrah nga shtetet e
demokracisë botërore, nga
Shtetet e Bashkuara të Amerikës,
nga shtete të BE-së dhe NATO.
Liria dhe pavarësia e Kosovës
themelet i ka te sakrificat e
dëshmorëve dhe martirëve të
saj", ka thënë Thaçi.
Në këtë akademi përkujtimore
presidenti Thaçi ka deklaruar se
Kosova do t'i ruajë dhe kultivojë
marrëdhëniet me shtetet e botës
perëndimore, në krye me Shtetet
e Bashkuara të Amerikës. Sipas
tij, Kosova është e sigurt në
rrugën e integritetit euroat-
lantike dhe do të bëhet pjesë e

BE-së, NATO-s dhe OKB-së.
Edhe kryeministri Ramush
Haradinaj ka marrë pjesë në
akademinë përkujtimore për t'i
kujtuar 147 shqiptarët e vranë
nga forcat serbe në Izbicë në
20-vjetorin e vrasjes së tyre. Para
të pranishmëve të shumë, për-
faqësues të institucioneve qen-
dore dhe lokale, bashkëlufetarë,
e familjarë të të vranëve të kësaj
masakre, kryeministri Haradinaj
ka thënë se edhe kjo ditë e sotme
është një prej atyre ditëve të
dhimbshme dhe, sipas tij, për fat
të keq, kemi shumë këso ditësh.
"Edhe familjarët e Izbicës,
masakrës më makabre që ka
ndodhur në Kosovë, ku është
vranë edhe fëmija pa i mbushur
një vjet, të moshuarit, të të dy
gjinive, pa qenë asnjëri luftëtar
ose pjesëtar, por të gjithë kanë
qenë qytetarë të pambrujtur, do
ta kishin më të lehtë sikur kjo të
ishte e vetmja, sikur kjo dhimbje
të ishte vetëm e juaja, por jemi
dëshmitarë që kjo dhimbje është
në gjithë atdheun tonë", ka
theksuar ai.
Kryeministri Haradinaj, duke



përmendur masakrat në qytete
dhe fshatra të shumtë të vendit,
ka thënë se është një ngecje dhe
punë e ngadalshme e zbardhjes
së fatit të të pagjeturve, por edhe
mosvendosjes para drejtësisë të
autorëve të këtyre krimeve,
masakrave, ku vetëm në
Dukagjin janë mbi dhjetë të
këtitilla.
Kryeministri Haradinaj ka thënë
se ka një dakordim ndërinstitu-
cional që të avancohet baza
ligjore dhe statusi ligjor edhe i
familjeve të martirëve, por edhe i

atyre të të pagjeturve, duke qenë
në komunikim me shoqatat e
dala nga lufta, edhe të statusit
ligjor të veteranëve, invalidëve,
familjeve të dëshmorëve. "I tërë
ky avancim i statusit ligjor prapë
nuk e zëvendëson asnjëherë jo
vetëm dhimbjen, por edhe
ndjenjën e gjithë neve se Kosova
kërkon drejtësi për këto krime
makabre që kanë ndodhur", ka
deklaruar Haradinaj, duke
falënderuar të gjithë për
nderimet që po ua bëjnë
martirëve e dëshmorëve në vend.



Veseli: Kosova nuk do ta harrojë kurrë masakrën në Izbicë dhe ato në gjithë Kosovën

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,
njëherësh lider i PDK-së, Kadri
Veseli, ka bërë homazhe në
fshatin Izbicë të Skenderajt, në
kujtim të viktimitave të masakrës
që forcat serbe kryen në këtë
vend 20 vjet më parë.
Kryeparlamentari Veseli ka
shkruar në llogarinë e vet në
"Facebook" se Kosova nuk do t'i
harrojë kurrë masakrat e kryera
nga Serbia, pasi harresa është
shërbim ndaj atyre që bënë krim-
in në Izbicë e në sa e sa fshatra
të Kosovës. "Sot është dita e

Izbicës. Ne kurrë nuk do të
harrojmë, sepse harresa është
shërbim ndaj atyre që bënë krim-
in në Izbicë e në sa e sa fshatra
të Kosovës. Nuk do të ndalemi
asnjëherë derisa të ketë drejtësi
për Izbicën. Drejtësi për
dhjetëra masakra që u kryen
mbi popullin tonë gjatë luftës.
Vetëm drejtësia i shëron plagët
e së kaluarës, ndërsa dëshmorët
mbesin përgjithmonë themeli
mbi të cilin qëndron shteti ynë i
pavarur dhe sovran", ka shkruar
Veseli.

Kosova do ta ndihmojë Maqedoninë për përkthimin e legjislacionit në gjuhën shqipe

PRISHTINË, 28 MARS (ER) -
Zëvendëskryeministri
i Republikës së Kosovës, Enver
Hoxhaj, ka takuar të enjten një
delegacion nga Maqedonia e
Veriut, i përbërë nga
zëvendëssekretari i përgjithshëm
i Qeverisë së Maqedonisë së
Veriut, Tahir Hani, si dhe Ylber
Sela, drejtor i Agjencisë për
Zbatimin e Ligjit për Gjuhët.
Në këtë takim u diskutua në
lidhje me bashkëpunimin në
mes të Kosovës dhe Republikës
së Maqedonisë së Veriut, për të
siguruar zbatim të plotë të Ligjit
për Gjuhët. Kosova do ta ndih-
mojë përgatitjen dhe përkthimin
në gjuhën shqipe të legjislacionit
atje. "Jam shumë i lumtur që

takova mysafirët nga Qeveria e
Maqedonisë së Veriut, Tahir
Hanin dhe Ylber Selën, për të
folur në lidhje me ndihmën dhe
mbështetjen që Kosova do t'ia
ofrojë Shkupit zyrtar përkthimin
e infrastrukturës ligjore në
gjuhën shqipe, pas miratimit të
Ligjit për Gjuhët muaj më parë",
ka thënë zëvendëskryeministri
Hoxhaj.
Duke e konsideruar shumë të
rëndësishëm për shqiptarët
miratimin e Ligjit për Gjuhët në
Maqedoninë e Veriut,
zëvendëskryeministri Hoxhaj
tha se Kosova do të jetë në
dispozicion për t'iu përgjigjur
kërkesave të Shkupit për ta
ndihmuar zbatimin e tij.



Kuvendi kërkon nga SBASHK-u ta gjejë mënyrën e kompensimit të orëve të humbura

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 28 MARS - Kuvendi i Kosovës të enjten ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme lidhur me çështjen e kompensimit të orëve të humbura të mësimit gjatë 15 ditëve të grevës së mësimdhënësve të shkollave fillore dhe të mesme në Kosovë në fillim të këtij viti.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka kërkuar që sa më shpejt të zgjidhet kjo çështje, duke propozuar që këto orë të zëvendësohen në fund të vitit shkollor. Ai ka thënë se Kuvendi mund të autorizojë Komisionin Parlamentar për Arsim që të takohet me përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit dhe të SBASHK-ut për të gjetur një zgjidhje rreth kompensimit të orëve të humbura.

Në seancën e jashtëzakonshme për kompensimin e orëve të humbura gjatë janarit, ka folur edhe kryeministri Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se kompensimi i orëve është në interes të të gjithëve.

Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, njëherësh propozuesi për mbajtjen e kësaj seance, Bilall Sherifi, ka thënë se si Kuvend nuk po e urdhërojnë askënd, por përmes kësaj projektrezolute të gjendet një zgjidhje në mënyrë që nxënësit mos të humbin. "Ne si Kuvend nuk po urdhërojmë askënd. Ne përmes kësaj projektrezolute po kërkojmë dhe po

konstatojmë gjendjen se njësitë mësimore duhet të plotësohen dhe kërkojmë nga aktorët që janë të përfshirë të ulen dhe të gjejnë zgjidhje. Kuvendi i Kosovës përmes rezolutës kërkon nga SBASHK-u që urgjentisht ta gjejë mënyrën t'i kompensojë orët e humbura gjatë këtij viti", ka thënë Sherifi. Për shkak të mungesës së kuorumit, Kuvendi i Kosovës nuk e ka votuar projektrezolutën për kompensimin e orëve të humbura nga SBASHK-u. Edhe ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka folur në seancë për çështjen e kompensimit të orëve të humbura të mësimit gjatë 15 ditëve të grevës së mësimdhënësve. Ai ka thënë se kjo seancë e jashtëzakonshme, bazuar në gjendjen që po krijohet, është më se e qëlluar. Bytyqi ka thënë se plotësimi i orëve të humbura, si pasojë e grevës së punëtorëve të arsimit, po bëhet një sfidë më vete. "Kohë më parë ne u ballafaquam me grevën e punëtorëve të arsimit të organizuar nga SBASHK-u. U dashtë kohë dhe angazhim i shumë faktorëve për të arritur një marrëveshje që, auditorët e arsimit t'i ktheheshin normalitetit. Marrëveshja ktheu në punë grevistët dhe risolli në procesin mësimor nxënësit e studentët, por nuk i ktheu humbjet që pësoi mosrealizimi i programeve mësimore nga orët e humbura. Sindikata e Punëtorëve të Arsimit mori një marrëveshje përmes një greve të



gjatë, ne Qeveria morëm mirëkuptimin e SBASHK-ut dhe funksionimin e procesit të arsimit, po shkollarët tanë çfarë morën? Ata rrezikohet të bëhen humbësit e mëdhenj, pa fajin e tyre", ka thënë ai.

Ministri Bytyqi ka theksuar se greva e punonjësve të arsimit, e drejtuar nga SBASHK-u kohë më parë, edhe pse e drejtë e tyre ligjore, edhe mekanizëm i pranuar demokratik, ka shkaktuar pasoja për faktorin më të rëndësishëm të sistemit arsimor, në atë të shkollarëve. "Mosrealizimi i programit mësimor është cilësi e munguar dhe kjo cilësi e munguar po na dëmton, e do të na dëmtojë në të gjitha planet qoftë për arritshmërinë, qoftë për standardet", ka thënë Bytyqi. Ai ka treguar se si ministër ka

lëshuar një vendim në dakordim të plotë me DKA-të për plotësimin e orëve të humbura, në bazë të ligjeve në fuqi, që e obligojnë MASHT-in për harmonizimin e kalendarit të vitit shkollor, që t'u mundësojë DKA-ve që në ekzekutim të këtij vendimi të përmbushen normat e parapara. "Kjo ka indinjuar SBASHK-un, e cila tashmë kërcënon me greva të tjera nëse do të mbetemi pranë vendimit tonë. Mosrealizimi i programit mësimor prodhon cilësi të munguar, dije të munguar, që do të thotë: shkronja të papërvetësuara nga nxënësit e klasës së parë, shumë njësi të pamësuar nga nxënësit e tjerë, rezultate më të dobëta në testin e arritshmërisë, një test të maturës me sukses të munguar për maturan-

tët dhe e tërë kjo është një kosto të cilën do ta paguajmë të gjithë si shoqëri", ka thënë ministri Bytyqi. Ai ka shtuar se si drejtues i dikasterit të arsimit nuk do të mund të pajtohet asnjëherë për ta quajtur të mbyllur një vit shkollor me program mësimor të përcaktuar. "Ne duhet të bëjmë gjithçka që është në dorën tonë, që nxënësit dhe studentët të marrin atë që u takon në të drejtën e tyre për t'u arsimuar, programin e plotë mësimor. Ne nuk jemi në gjendje të jashtëzakonshme, lufte a katastrofe natyrore, që të mund të pranojmë shkurtime të tilla. E thërras SBASHK-un të reflektojë, se dinjiteti i saj brendaorganizativ nuk mund e as duhet të quhet interes më madhor sesa arsimimi i shkollarëve tanë", ka thënë ministri Bytyqi.

Komunat mbesin pa certifikata


EPOKA
ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 28 MARS - Anulimi i tenderit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), me certifikata nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit, ka bërë që furnizimi me certifikata në të gjitha komunat të dështojë.

Komuna e Prishtinës ka njoftuar se nga dita e enjte, pas orës 12:00, zyrat e Gjendjes Civile në Komunën e Prishtinës nuk do të jenë në funksion. "Njoftohen të gjithë qytetarët se, si pasojë e anulimit të tenderit të Ministrisë së Punëve të Brendshme me certifikata nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit, ka dështuar furnizimi me certifikata në të gjitha komunat. Me sasinë e certifikatave që momentalisht disponojmë në Komunën e Prishtinës, shërbimet mund të ofrohen deri sot, 28 mars 2019, në orën 12:00. Pas orës 12:00, zyrat e Gjendjes Civile në Komunën e Prishtinës nuk do të jenë në funksion", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës. Ndërkaq Agjencia e Regjistrimit

Civil e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka bërë me dije se me kohë ka planifikuar iniciimin e zhvillimit të procedurave të prokurimit për furnizim me dokumente të gjendjes civile për zyrat komunale të gjendjes civile mirëpo, për arsye procedurale, ende nuk është përzgjedhur operatori për furnizim me dokumente të gjendjes civile. Me këtë rast, Agjencia e Regjistrimit Civil, si organi më i lartë i gjendjes civile në Republikën e Kosovës, ka kërkuar nga të gjitha zyrat komunale të gjendjes civile në Kosovë që në mungesë të formularëve të përdoren metodat alternative.

ARC-ja u ka dërguar një njoftim të gjitha zyrave të gjendjes civile, që në mungesë të formularëve (dokumente të gjendjes civile), me qëllim të realizimit të të drejtave të qytetarëve për pajisje me dokumente të gjendjes civile, të fillohet me lëshimin e dokumenteve me letër të bardhë nga sistemi i gjendjes civile, deri në njoftimin tjetër. "Këto dokumente do të përdoren vetëm për përdorim të brendshëm në të



gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Kërkojmë ndjesë nga qytetarët e Kosovës për mungesë

sat e formularëve, megjithatë shërbimi për qytetarët do të vazhdojë të mbetet një prej prior-

iteteve tona më të rëndësishme", është bërë me dije në njoftimin e ARC-së.

Ambasada britanike tërhiqet nga rekrutimi i pozitës së kryesuesit të Bordit të ZRRE-së

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 MARS - Ambasada britanike në Kosovë ka tërhequr mbështetjen për rekrutimin e pozitës së kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) si pasojë e, siç thuhet, zhgënjimit me vendimin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për mosvotimin e asnjërit nga kandidatët e rekomanduar nga partneri zbatues i Projektit të Rekrutimit. Në një komunikatë për media, Ambasada ka theksuar se më 28 shkurt deputetët kanë dështuar t'i votojnë kandidatët e propozuar për këtë pozitë dhe janë të detyruar ta rishpallin konkursin. Pas këtij vendimi, ambasada ka njoftuar se nuk do të financojë procese të reja rekrutuese "për shkak të mungesës së vullnetit të deputetëve për të emëruar kandidatët të përgatitur". "Kandidatët e rekomanduar ishin përzgjedhur përmes një procesi të mirëstrukturuar, profesional dhe meritokratik. Ata kishin plotësuar të gjitha kriteret dhe kishin treguar që kanë kompetencat e duhura për ta ushtruar pozitën e

Kryesuesit të Bordit të ZRRE-së. Pavarësisht një procesi të tillë rekrutues transparent, deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk e kishin votuar asnjërin prej kandidatëve të rekomanduar. Ky dështim në emërimin e njërit nga kandidatët e rekomanduar është në kundërshtim me Memorandumin e Bashkëpunimit të nënshkruar nga Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës", është thënë në komunikatën e kësaj ambasade. Sipas Ambasadës së Britanisë, ky vendim vë në dyshim qëllimin dhe vullnetin politik të deputetëve të Kuvendit të Kosovës për emërimin profesional në pozita të larta drejtuese në institucione të cilat do të duhej të ishin të pavarura dhe sektorë me rëndësi jetike për resurset dhe ekonominë e Kosovës.

Në vitin 2016, Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës kishin nënshkruar memorandum mirëkuptimi për pavarësimin e bordeve të agjencive të pavarura, proces i cili monitorohet nga Ambasada e Britanisë.

Ambasadori britanik në Kosovë, në trevjetorin e këtij projekti, duke iu referuar punësimeve mbi



baza partiake dhe familjare, kishte theksuar se "qasja e institucioneve të Kosovës në favor të nepotizmit ndikon në penalizimin e profesionalitetit, çka rrjedhimisht, sipas tij, dëmton punësimin mbi bazën e meritave në pozitë të larta drejtuese".

Edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës javë më parë kanë reaguar lidhur me emërimin e Naser Shalës nga Kuvendi i Kosovës, në pozitën e drejtorit të Sekretariatit të Agjencisë Kosovare të Krahasimit dhe Verifikimit të Pronës.

Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryetarit të Bordit të kësaj agjencie në shenjë pakënaqësie për emërimin e Shalës, duke e konsideruar se ai nuk i ka përmbushur kriteret.

Bizneset e Kosovës dhe ato hungareze shkëmbejnë përvoja për zhvillimin e bujqësisë

PRISHTINË, 28 MARS (ER) - Ambasada hungareze në Kosovë, në bashkëpunim dhe me përkrahjen e Ministrisë së Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), kanë mbajtur konferencën e titulluar "Konferenca për bujqësinë hungareze në Kosovë". Kjo konferencë, e cila është mbajtur në hotel "Amazona" në Prishtinë, mbledhi biznese të ndryshme nga Kosova dhe Hungaria, ku bizneset e ardhura nga Hungaria kishin për qëllim prezantimin e veprimtarive të tyre dhe ofrimin e partneritetit me bizneset e Kosovës që ishin të pranishme në këtë konferencë.



Në fjalët e tyre hyrëse, përfaqësuesit nga Ministria e Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ambasada e Hungarisë i falënderuan të pranishmit për pjesëmarrjen dhe shprehën gatishmërinë për përkrahje në ndërtimin e kontakteve mes bizneseve të të dyja vendeve, si dhe për thellimin e bashkëpunimit në të ardhmen. Bizneset e Kosovës dhe ato hungareze patën mundësinë e prezantimit të veprimtarive të tyre dhe të shkëmbimit të përvojave përmes sesionit të takimeve individuale, gjë që nga palët u cilësua si shumë i frytshëm.

Të pranishëm në këtë konferencë ishin edhe studentët të Universitetit të Prishtinës të cilët Ambasada e Hungarisë i përkrah çdo vit me bursa studimi, me ç'rast ata u shprehën të kënaqur me përkrahjen e tyre.

Të pranishmit, në pjesën përmbyllëse të konferencës, u falënderuan nga organizatorët për pjesëmarrjen dhe organizatorët u zotuan se kjo konferencë do të vazhdojë të jetë tradicionale, duke u zgjeruar çdo vit në aspektin e bashkëpunimit dhe lidhjes së kontakteve në mes të bizneseve kosovare dhe atyre hungareze.

Bankierët e rinj informohen për funksionimin e BQK-së

PRISHTINË, 28 MARS (ER) - Zyrtarë të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) kanë mbajtur të enjten një ligjëratë me bankierët e rinj nga Banka Private e Biznesit në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Parasë në funksion të edukimit financiar. Para bankierëve të rinj është shpjeguar roli i BQK-së dhe përgjegjësitë e saj. Shefi i kabinetit të guvernatorit të BQK-së, Nexhat Miftari, ka bërë me dije se Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka misionin ta ruajë stabilitetin financiar, të sigurojë sistem efektiv të pagesave dhe furnizim

me para të gatshme si dhe t'i ofrojë këshilla ekonomike Qeverisë dhe subjekteve të tjera publike. Gjithashtu, ai ka theksuar se BQK-ja, edhe pse nuk është e përfshirë në dizajnimin, shtypjen dhe prerjen e monedhës euro, siguron që vendi të ketë sasi dhe cilësi adekuate të monedhës së euros. "Në vitin 2002 BQK-ja themeloi sistemin e pagesave ndërbankare, kurse nga viti 2011 jemi bërë anëtarë të SWIFT-it", ka deklaruar ai. Miftari ka folur edhe për mbikëqyrjen bankare ku aktualisht në Kosovë janë të licencuara dhjetë banka, tetë prej të cilave janë me kapital të huaj dhe dy

banka me kapital vendor. "Vlera e gjithsej mjeteve të sektorit bankar në janar të vitit 2019 arriti në 4.163 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.6 përqindësh krahasuar me janarin e vitit 2018. Gjithsej kreditë (bruto) në janar të vitit 2019 ishin në shumë prej 2.75 miliardë eurosh, të cilat shënuan rritje vjetore prej 11.4 përqindësh. Depozitat në janar të vitit 2019 evidentojnë 3.348 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 8.4 përqindësh. Treguesi i kredive joperformuese ishte në normën prej 2.6 përqindësh në janar të vitit 2019 nga 3.1 për qind sa



ishite në janar të vitit 2018", ka thënë Miftari. Ai ka shtuar se nivelet e kapitalit të bankave janë të mjaftueshme për ta mbështetur profilin e rrezikut të

tyre, pasi ato janë mbi minimumin e kërkuar rregullator. Miftari i ka informuar bankierët e rinj edhe për ndryshimet ligjore dhe ato rregullative.

Përmbillet programi për bursa 'Gratë në energji'

Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës ka përmblytur turin e sesioneve informative për programin e bursave "WE - gratë në energji". Nëpërmjet këtij programi 25 vajza dhe gra të Kosovës do të kenë mundësi të përfitojnë bursa të plota të studimeve dhe qëndrim dyvjeçar në Iowa të ShBA-së dhe në kolegje të tjera të akredituara

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 MARS - Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës (MFK) ka përmblytur të enjten në Prishtinë turin e sesioneve informative për programin e bursave "WE - gratë në energji". Nëpërmjet këtij

programi, 25 vajza dhe gra kosovare do të kenë mundësi të përfitojnë bursa të plota të studimeve dhe qëndrim dyvjeçar në Iowa të ShBA-së dhe kolegje të tjera të akredituara. Burim Hashani, drejtor i programit të energjisë në MFK, në hapjen e sesionit informativ ka prezantuar qasjen e MFK-së

për uljen e pabarazisë gjinore në sektorin e energjisë përmes projekteve të ndryshme në këtë sektor.

Programi i bursave "WE - gratë në energji" ka thënë ai është program që synon të adresojë një çështje alarmante në sektorin e energjisë në Kosovë, pjesëmarrjen e ulët të grave në këtë sektor.

Ai ka theksuar se ky program do t'i mbështesë gratë dhe vajzat që të avancohen nga ana profesionale dhe ta lehtësojë procesin e gjetjes së punës në këtë sektor.

Ndërkaq për programin e ardhshëm për gratë ndërmarrëse, Hashani ka thënë se ky

program do të aspirojë t'i ndihmojë gratë që ta ulin koston e veprimtarisë së tyre ndërmarrëse përmes uljes së koston së energjisë.

Kevin Mitchell, përfaqësues nga MCC-ja, ka prezantuar programin "Threshold" nga ky institucion për Kosovën, si dhe rezultatet shqetësuese të dala nga sondazhi i pjesëmarrjes në punë. Mitchell ka pohuar se një nga aspiratat e kësaj agjencie është rritja e participimit të grave në sektorin e energjisë. Ai ka thënë se ky shans për të studiuar në ShBA u mundëson grave dhe vajzave nga Kosova ngritjen e tyre profesionale dhe personale si dhe kthimin në

Kosovë për të kontribuar në zhvillim të mëtejshëm ekonomik.

Gresa Statovci, konsulente për punë praktike dhe bursa në MFK, ka prezantuar të gjitha informacionet lidhur me procesin e aplikimit për bursa në DMACC, Iowa. Ajo ka përfunduar sesionin duke ndarë me vajzat përvojën personale të saj si bursiste në ShBA. Statovci ka inkurajuar vajzat dhe gratë që ta shfrytëzojnë këtë mundësi për zhvillim të aspektit profesional.

Periodha për aplikim për bursë të plotë për avancim profesional në sektorin e energjisë mbetet e hapur deri më 7 prill 2019.



MTI-ja dhe IFC-ja, projekt që mbështet prodhuesit vendorë

PRISHTINË, 28 MARS (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka pritur në takim Damien Shiels, menaxherin për Evropën dhe Amerikën Latine në IFC me ekipin e tij. Ata kanë bashkëbiseduar për projektet e ardhshme që do t'i realizojë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Shala ka theksuar se IFC-ja konfirmoi se së shpejti do të fillojë me një projekt të ri t'i mbështesë prodhuesit vendorë, kryesisht në prodhimtarinë

teknologjike, që mundëson fuqizimin e tyre dhe hapjen e vendeve të reja të punës. "Temë e debatit ishte edhe shkëmbimi i përvojave në tërheqjen e investimeve me vendet e ngjashme siç është Irlanda. U vlerësua edhe fuqizimi i mekanizimit për trajtimin e ankesave për investitorët, që do të bëhet në kuadër të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është falënderuese ndaj IFC-së dhe

Qeverisë Zvicerane për mbështetjen e deritanishme dhe ne jemi të gatshëm për ta vazhduar bashkëpunimin në projektet që na presin për të ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendit", ka deklaruar ministri Shala. Ndërsa Damien Shiels ka konfirmuar se së shpejti IFC-ja do të nisë një projekt të ri në mbështetje të prodhuesve vendorë, duke ndikuar edhe në hapjen e vendeve të reja të punës.



Hemodializat e spitaleve të përgjithshme po kryejnë qindra dializa brenda dite

GJILAN, 28 MARS (ER) - Puna në Qendrat e Hemodializës në spitalet e përgjithshme po kryhet me kapacitete të plota, me staf profesional dhe furnizim të kënaqshëm. Për t'u informuar nga afër me punën e stafit të qendrave të dializës, drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, së bashku me koordinatoren për hemodializë, dr. Hajrije Korça dhe drejtore-shën e Klinikës së

Nefrologjisë, dr. Venera Gjuka-Hasanxhekaj, kanë vizituar qendrat e dializës në Gjilan, Ferizaj dhe Pejë, për t'u siguruar për mbarëvajtjen e punës, furnizimin dhe problemet eventuale. Në bisedë me mjekë dhe teknikë përgjegjës për hemodializë dhe me pacientë, drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, është informuar për trajtim profesional dhe furnizim adekuat.



Ramosaj nderon eprorët e UÇK-së, Elez Gecin dhe Magjun Berishën

Deçan, 28 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka përkujtuar të enjten eprorët e UÇK-së, Elez

Gecin dhe Magjun Berishën, në fshatin Pozhar si dhe dëshmorët e viteve '90, Sali Hadërgjonajn në fshatin Voksh, Ismet Qorrajn

në fshatin Carrabreg, Agim Kuklecin në fshatin Isniq dhe Mujë Mehmetajn në fshatin Maznik.



Alternativa do të iniciojë kallëzim penal ndaj Ardian Gjinit për kullën e 'Sylejman Vokshit'

GJAKOVË, 28 MARS (ER) - Partia Alternativa, e drejtuar nga Mimoza Kusari-Lila, ka njoftuar se do të iniciojë kallëzim penal ndaj kryetarit të Komunës së Gjakovës, Ardian Gjinit, si dhe 18 asamblistëve të tjerë që kanë votuar një vendim të jashtëligjshëm, atë për shfuqizimin e shpronësimit rreth kullës së 'Sylejman Vokshit'. "Kryetari i


Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini dhe kryesuesi i Kuvendit, Anton Shala, sërish sot kanë shkelur procedurat ligjore, duke mos lejuar që në rendin e ditës të përfshihet rekomandimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe Ministrisë së Administratës dhe Pushtetit Lokal për joligjshmërinë e vendimit për shfuqizimin e

shpronësimit rreth kullës së 'Sylejman Vokshit', është thënë në njoftimin e kësaj partie. Gjithashtu, Alternativa ka paralajmëruar se do ta iniciojë edhe mbledhjen e jashtëzakonshme për shfuqizimin e planit urbanistik "Gjakova Qendër 2005", që parandalon ndërtimet e planifikuara nga qeverisja Gjini rreth kullës së 'Sylejman Vokshit'.

Universiteti 'Isa Boletini' bëhet me Qendër të Ekspertizës për industrinë e qumështit

MITROVICË, 28 MARS (ER) - Në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore (FTU) të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë do të hapet Qendra e Ekspertizës që ka për qëllim trajtimin e ujërave të shkarkuara nga industria e qumështit si dhe rritjen e cilësisë së prodhimeve të qumështit. Për këtë qëllim është nënshkruar një marrëveshje ndërmjet Shoqatës së Qumështarëve të Kosovës (SHQK), FTU-së, Universitetit "Van Hall Larenstein" nga Holanda si dhe organizatës "YUNIKO", të krijuar në Holandë, që janë partnerë të këtij projekti. Dekani i FTU-së, Milaim Sadiku, ka thënë se ideja është që kjo Qendër e Ekspertizës të shërbejë si një qendër rajonale edhe për shtetet si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. "Duke pasur parasysh zhvillimin e industrisë së qumështit dhe nevojën për

trajtimin e ujërave të shkarkuara si dhe rritjen e cilësisë së qumështit, kjo qendër do të jetë jashtëzakonisht e rëndësishme për këtë sektor", tha ai. Sipas tij, objektivi i parë i Qendrës së Ekspertizës është që ta lehtësojë ShQK-un për t'u bërë më e qëndrueshme dhe më konkurruese. "Fokusi do të jetë në sfidat lidhur me trajtimin e ujërave të zeza, përmirësimin e proceseve të prodhimit dhe eficiencën e energjisë", ka thënë Sadiku. Ndërsa si objektivi e dytë, sipas dekanit Sadiku, është që Qendra e Ekspertizës të krijojë një ndërlidhje bashkëpunimi mes sektorit të qumështoreve të Kosovës dhe atyre evropiane nëpërmjet ndërlidhjes me organizatat nga shtetet BE-së. Në këtë kontekst, ai përmendi edhe pjesëmarrjen në projektet e BE-së dhe atyre vendore si dhe zhvillimin e ekspertizës dhe njohurive përmes shkëmbimeve me BE-në.



Aforizma për politikanët që dëgjojnë



Prof. Lisen BASHKURTI

- Në politikë mos u trembni shumë nga humbja, sepse çdo betejë politike e humbur është një mësim drejt fitores, në mos për ju, për pasardhësit tuaj.
- Jo çdo humbje e juaja politike është humbje e interesave publike. E sa kohë ka ndryshim midis tyre, humbja juaj politike mund të jetë fitore për interesat publike.
- Një politikan që vë interesat

publike në plan të parë nuk dëshpërohet për humbjen e tij kur ajo u shërben interesave publike. Politikani me vlerë thellë-thellë i gëzohet fitores së interesave publike, edhe kur vetësakrifikohet.

- Nëse humbja politike nuk sjell fitore të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë për ju, pa dyshim sjell një fitore më të gjerë dhe më afatgjatë për të tjerë, pra për interesat publike, brenda të cilave edhe ju nuk do të ndiheni më i humbur.

- Nuk ka fitore politike pa humbje pasuese. Humbja është një shkallë drejt fitores, në mos për ju, për të tjerët; në mos për politikanin, për interesat publike. Kështu që një politikan kur fiton duhet të përgatitet për humbje.

- Politikani i mirë përmban euforinë e fitores, por kontrollon

edhe dëshpërimin e humbjes. Pra, politikani i zoti pret humbjen me po aq qetësi sa edhe fitoren.

- Në politikë gëzoju humbjes së merituar dhe në kohën e duhur më shumë sesa fitores së pamërituar dhe në kohë të gabuar.

- Pushteti i ngritur mbi themele injorance dhe pasuria e bërë mbi të nuk prodhojnë qëndrueshmëri dhe lumturi për askënd.

- Mashtrim më i madh se çdo shpifje individuale është propaganda politike. Shpifja e një individi bie mbi kokën e atij që e bën. Propaganda politike bie mbi kokën e një populli të tërë.

- Politikani që flet shumë nuk ka kohë të mendojë dhe aq më pak të punojë. Ruaju politikanit që flet shumë sepse mund të ta helmojë edhe trurin. Helmi i trurit

është më dëmprurës se çdo helm tjetër.

- Politikani që nuk i ndahet mikrofonit, kamerave dhe mediave sociale, e konsumon veten përpara opinionit publik si sapuni, vlera e të cilit përfundon nëpër tubat e lavamanëve.

- Politikani i mençur lypet të kënaqet kur të tjerët e vlerësojnë punën e tij dhe jo kur vetëvlerëson punën e tij përpara të tjerëve.

- Politikani nuk duhet të tërhiqet nga politika vetëm atëherë kur mendon vetë, por kryesisht kur të tjerët mendojnë se ai duhet të largohet. E para do ta baltosë përjetësisht politikanin, e dyta do ta rivlerësojë me kalimin e kohës.

- Politika është çështje publike, prandaj i mençur është ai politikan që e kupton se kur humbja

e tij është në interes publik, ajo do të shënojë një fitore pa të humbur.

- Në politikë jo kurdoherë mbrojtja më e mirë është sulmi. Në politikë, përkundrazi, në mjaft raste sulmi më i mirë është tërheqja.

- Në politikë, kur mendon se ke humbur, ke kuptuar thelbin se si të fitosh ose, së paku, se si të mos humbasësh më. Nëse nuk e kupton ti, të jesh i bindur se të tjerët rreth teje apo pas teje do ta kuptojnë.

- Nëse ju nuk keni kohë të përfitonit më nga përvoja e humbjes suaj politike, të tjerët pa dyshim do të dinë të përfitojnë patjetër prej saj. Lypset t'i gëzoheni edhe fitores së kundërshtarëve, nëse humbja juaj u ka shërbyer atyre si përvojë pozitive.



Begaj: Do ta vazhdojmë bashkëpunimin me Postën e Kosovës

MALISHEVË, 28 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka prituri të enjten në takim pune kryeshefin ekzekutiv të Postës së Kosovës, Sejdi Hoxha, i cili ishte i shoqëruar edhe nga përgjegjësit e postave në Malishevë dhe Kijevë, Asllan Kastrati dhe Sylë Dukolli. Ky takim kishte karakter njoftues lidhur me shërbimet që ofron Posta e Kosovës. Kryeshefi ekzekutiv i Postës së Kosovës, Sejdi Hoxha, e ka njoftuar kryetarin Begaj me shër-

bimet që ofron posta, bashkëpunimin me institucionet vendore, ofrimin e shërbimit të pagesave për shërbimet e caktuar, si dhe nevojën që këto shërbime të jenë më efikase dhe sa më afër qytetarit, e që mund të realizohen në bashkëpunim me institucionet.

Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka thënë se si komunë do ta vazhdojë bashkëpunimin me Postën e Kosovës, në mënyrë që qytetarët t'i kenë shërbimet më të shpejta dhe më të lehta.

Reçica vlerëson pozitivisht angazhimin e Zyrën së Punësimit në Mitrovicë

Mitrovicë, 28 mars (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, ka vizituar të enjten Zyrën e Punësimit në Mitrovicë, ku është njoftuar nga përfaqësuesit e kësaj zyre rreth angazhimit të tyre në shërbim të punëkërkuësve. Reçica ka thënë se falë skemës së punësimeve, Arbenita nga Mitrovica ka hapur biznesin e saj,

e cila tani është duke kërkuar punëtorë në Zyrën e Punësimit në këtë komunë. "Vizitova Zyrën e Punësimit në Mitrovicë. Aty pashë angazhimin që bëhet në shërbim të punëkërkuësve dhe punëdhënësve. Shumë punëkërkuës që i drejtohen kësaj zyre dhe përfitojnë nga mundësitë për aftësim profesional dhe në masa aktive të

tregut të punës, kthehen pikërisht aty pas një kohe si punëdhënës, siç është rasti i Arbenitës të cilën pata kënaqësinë ta takoj. Arbenita, përfituese nga Skema e Vetëpunësimit, vitin e kaluar ka hapur biznesin e saj, ndërkaq sot ajo është drejtuar në po këtë zyrë të punësimit për të kërkuar punëtorë", ka shkruar Reçica në llogarinë e vet në "Facebook".



Vushtrria shpallet komuna më transparente në prokurim për vitin 2018

VUSHTRRI, 28 MARS (ER) - Demokraci Plus (D+) ka publikuar raportin e dytë të vlerësimit gjashtëmujor mbi prokurimin publik në nivel komunal për periudhën janar-korrik 2018, duke u fokusuar në pesë komuna: Gjakovë, Gjiilan, Pejë, Prishtinë dhe Vushtrri.

Ky raport krahasues ka analizuar performancën e këtyre

komunave në efektivitetin e prokurimit, integritetin, transparencën dhe cilësinë e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve. Raporti i Demokracisë Plus ka vlerësuar performancën e komunave përmes një numri indikatorësh, si: "zbatimin e ligjit", "praktikat e mira", "zbatimin e rekomandimeve nga institucionet mbikëqyrëse", "trans-

parencën", "konkurrencën" dhe "përfshirjen qytetare". Bazuar në këtë analizë, Demokracia Plus ka gjetur që Komuna e Vushtrrisë, Prishtinës dhe Pejës janë performueset më të mira gjatë gjysmës së parë të vitit 2018. Sipas këtij raporti, Komuna e Vushtrrisë është shpallur komuna më transparente në prokurim gjatë vitit 2018.



E rrallë

Italia i rikthen 800 artefakte të lashta Kinës

Pothuajse 800 vazo dhe skulptura të lashta po shkojnë në shtëpinë e tyre në Kinë, pasi Italia ka njoftuar se do t'i kthente objektet e paligjshme. Disa prej objekteve datojnë që nga periudha neolitike, ndërsa disa të tjerë nga dinastia e Ming (907-1664). Kështu është bërë me dije në deklaratën e lëshuar të premten nga Ministria e Trashëgimisë Kulturore dhe Aktiviteteve të Italisë.



FOTO E DITES



Një shitës i petullave afgane shihet duke kryer shërbimin për klientët e tij në Kabul. /AFP/

E jashtëzakonshme

Fshati ku askush nuk pi duhan

Edhe pse Greqia është një prej vendeve ku duhani konsumohet më shumë në Evropë, është një fshat ku askush nuk tymos. Fshati ndodhet në Kretë dhe mburret me faktin se aty nuk pihet duhan nga asnjë person i vetëm. Fshati quhet Skotino dhe ndodhet në Bashkinë e Hersonissos, Heraklion. 40 vjet më parë banorët vendosën ta linin duhanin.



BARSOLETA E DITËS



**Djali: Oj gjyshe po shumë të dua!
Gjyshja: Allahile kush të tregojë që e mora pensionin?**



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

“HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World” 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 18:00

“CAPTAIN MARVEL” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.
Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

“THE KID WHO WOULD BE KING”,

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.
Regjia: Joe Cornish




Regjia: Joe Cornish

Në ora 22:00 “U S”

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon
Regjia: Academy Award®-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Sot gjërat do të shkojnë mjaft mirë. Nuk do të mungojnë suksese në sektorin profesional dhe atë social. Në mbrëmje do të kaloni çaste të paharrueshme me njeriun e zemrës.</p>	 <p>DEMI Duhet të mësoheni ta respektoni ritmin natyral të ngjarjeve: mos pretendoni t'i përshpejtoni ose t'i ngadalësoni sipas nevojave tuaja. Parashikohet një mbrëmje mjaft argëtuese për shumë nga ju.</p>	 <p>BINJAKËT Sot do të jeni mjaft të ndjeshëm, të pakënaqur për çdo gjë dhe nuk do të arrini t'i kuptoni mirë personat që ju rrethojnë, përfshirë këtu edhe njeriun e zemrës. Mundohuni ta ruani qetësinë!</p>	 <p>GAFORRJA Kjo periudhë do të jetë paksa e lodhshme për ju dhe dëshironi të kaloni një ditë të qetë. Duhet thjesht të jetoni deri në fund të gjitha përvojat pozitive që ju ofron dita e sotme. Kini kujdes me shpenzimet.</p>	 <p>LUANI Hëna ju dhuron energji të vlefshme, që do t'ju duhen për t'i realizuar projektet që keni më shumë për zemër. Në punë do të merrni një ndihmë të papritur.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Në sektorin financiar parashikohet përfitime ekstra, por që do të nevojiten për t'i balancuar shpenzimet që keni bërë kohë e fundit. Por nuk mund të themi të njëjtën gjë për sektorin e ndjenjave.</p>
 <p>PESHORJA Hëna dhe Saturni sot mund të krijojnë dyshime dhe debate, si dhe ta ndezin xhelozinë tuaj ndaj partnerit. Edhe në punë duhet të përballoni ndonjë vështirësi, pak më shumë kujdes nuk do të ishte keq.</p>	 <p>AKREPI Sot do t'ju karakterizojë një humor dhe optimizëm i shkëlqyer. Shfrytëzoni më së miri këtë ditë në qoftë se doni të bëni hapa para në punë ose t'i jepni jetë një bashkëpunimi të ri.</p>	 <p>SHIGJETARI Dita e sotme mund të fillojë me një tension në ambientin familjar. Afërdita ju këshillon të dëgjoni disa këshilla të partnerit, edhe pse nuk jeni plotësisht dakord me to.</p>	 <p>BRICJAPI Gjallëria dhe harmonia që ju karakterizon sot do t'ju lejojë të ndërthurni marrëdhënie të këndshme sociale. Gjithashtu, do të jeni mjaft romantik e do t'i kushtoni shumë vëmendje njeriut që dashuron.</p>	 <p>UJORI Jeta private do të jetë në plan të parë. Humori i mirë dhe qetësia në marrëdhëniet sentimentale do të kompensojnë një moment jo fort të mirë në sferën profesionale.</p>	 <p>PESHQIT Sot do të jeni të gatshëm për të ndihmuar miq e të afërm. Do ta keni më të lehtë ta rifitoni besimin dhe simpatinë e tyre, duke dhënë prova altruizmi dhe bujarie.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

FFK-ja ndan pension për bashkëshorten e Fadil Vokrrit

Kuvendi i Punës i Federatës së Futbollit të Kosovës përfundoi pa "zhurmë" dhe pa mocion për rrëzimin e kryetarit Agim Ademi. Në këtë Kuvend është marrë vendim që t'i ndahet pension bashkëshortes se ish-kryetarit të FFK-së, Fadil Vokri, i cili ndërroi jetë në qershor të vitit të kaluar

**EPOKA ERE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 MARS - Pavarësisht se ishte paralajmëruar se do të jetë i "nxehtë" Kuvendi i Punës i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) dhe do të kërkohet mocion për rrëzimin e kryetarit të FFK-së, Agim Ademi, nuk ndodhi si pritej. Në fakt, Kuvendi i Punës rrodhi normalisht, kurse në të u vendos që t'i ndahet pension bashkëshortes së legjendës së futbollit të Kosovës dhe ish-kryetarit Fadil Vokri, i cili ndërroi jetë më 9 qershor të vitit të kaluar.

Në fjalën e tij, kryetari Agim Ademi foli për sukseset e Përfaqësueses së Kosovës e cila arriti sukses historik në Ligën e Kombeve, kurse luajti baras me Danimarkën (2-2) në miqësore dhe më Bullgarinë (1-1) në kualifikueset për Kampionatin Evropian. "Kosova është

storie e suksesit në UEFA. Suksesi ka ardhur nën trajnerin Bernard Challandes dhe shpresojmë që Kosovën do ta shohim në Kampionatin Evropian 2020", ka thënë Ademi, i cili ka folur edhe për investimet në stadiumin 'Fadil Vokri' si dhe për projektet që do të vazhdojnë në këtë vit, duke filluar nga me Kampin Nacional në Obiliq dhe Shtëpinë e Futbollit.

Ademi falënderoi edhe presidentin e Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, për ofrimin e mundësisë së shfrytëzimit të stadiumit 'Loro Boriçi' në Shkodër për ndeshjet kualifikuese të Kampionatit Botëror. I pranishëm në cilësinë e delegatit të UEFA-s ishte edhe presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka. Sipas Dukës, Kosova me sukseset që do t'i arrijë do të bëjë të pendohen të gjithë ata që ishin kundër anëtarësimit të saj në UEFA dhe

FIFA. "Federata e Kosovës me ekipin kombëtar do të bëjë të pendohet këdo që nuk ka qenë në favor të anëtarësimit të Kosovës në UEFA dhe FIFA. UEFA është fuqishëm në përkrahje të presidentit të FFK-së, Agim Ademit. Në këtë Kuvend jam i nderuar që vijmë, por edhe i trishtuar sepse mungon miku im dhe ish-presidenti i FFK-së, Fadil Vokri", ka deklaruar Duka.

Duhet cekur se unanimisht janë miratuar raportet për aktivitetet dhe të arriturat, raporti financiar dhe ai i garave. Të hyrat financiare kanë arritur shifrën e 11 milionë e 38 mijë eurove. 88.86 për qind e të hyrave për vitin 2018 janë nga FIFA dhe UEFA, të tjerat nga sponsorët, ministria, dënimet e shqiptuara në ligë dhe të drejtat televizive. Të shpenzuara janë 11 milionë e 47 mijë euro. Po ashtu, është propozuar që numri i skuadrave në Superligë të zvogëlohet nga dymbëdhjetë në dhjetë skuadra.

SHKURT

U17-shtat mposhten nga Spanja

Përfaqësuesja U17 e Kosovës në futboll pësoi humbje nga Spanja (1-0) në kuadër të Grupit 5 të Raundit Elitë në kualifikimet për "Euro 2019". Në minutën e 54-t, Pablo Moreno shënoi golin e vetëm të ndeshjes. Kosova është në grupin e pestë së bashku me Spanjën, Ukrainën dhe Greqinë. Para humbjes nga Spanja, Kosova u mposht edhe nga Ukraina.

Aliti në formacionin më të mirë të ndeshjeve të kombëtareve

Revista prestigjioze 'France Football' ka publikuar formacionin më të mirë nga ndeshjet e kombëtareve dhe Fidan Aliti është pjesë e tij. Mbrojtësi i Kosovës, Fidan Aliti, ka zënë një vend në formacionin më të mirë të kombëtareve për muajin mars. Aliti, që kishte paraqitje fantastike ndaj Danimarkës dhe Bullgarisë, është rreshtuar përkrah Kylian Mbappes dhe Rapahel Varanres dhe Roos Barkley. Formacioni: Keet, Danilo, Varane, Aliti, Schulz, Dzudzsak, Barkley, Spinazzola, Mbappe, Zagavi, GNABRY.

Kampionet e Evropës në xhudo përfaqësojnë Kosovën në Gjeorgji

Kryeqyteti i Gjeorgjisë, Tbilisi, është ndalesa e radhës e xhudisteve të Kosovës në rrugën drejt Lojërave Olimpikë "Tokio 2020". Në Tbilisi nga sot (e premte) deri të dielën do të zhvillohet Grand Prix i xhudos, garë kjo e vlefshme për të fituar pikë olimpikë. Kosovën do ta përfaqësojnë kampionia e Evropës, Nora Gjakova, njëherësh sportistja më e mirë e Kosovës për vitin 2018, e zgjedhur nga Komiteti Olimpik i Kosovës, si dhe kampionia e Evropës për U-23, Loriana Kuka. Nora garon të premtën në kategorinë deri në 57 kilogramë, ndërsa Loriana të dielën në kategorinë deri në 78 kilogramë. Garueset e tjera Majlinda Kelmendi dhe Distria Krasniqi, po dhe Akil Gjakova, do të pushojnë. Të pesë xhudistët momentalisht kanë normat olimpikë "Tokio 2020". Nora është e katërta në kategorinë e saj në renditjen olimpikë, ndërsa Loriana e 15-ta.

Sot takohen Ferizaj - Drita dhe Liria - Llapi

PRISHTINË, 28 MARS - Sot (e premte) zhvillohen dy ndeshjet e para të javës së 24-t në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra e Ferizajt që po lufton për mbijetesë do të ketë punë shumë të vështirë

ndaj kampionet aktuale, Dritës nga Gjilani. Ndërsa ndeshja kryesore sot do të jetë ajo që zhvillohet në stadiumin "Përparim Thaçi" ku takohen Liria dhe Llapi, dy skuadra me synime të kundërta,

pasi prizrenasit luftojnë për mbijetesë e llapjanët për titull. Të shtunën zhvillohen dy ndeshjet e tjera ku takohen Gjilani - Trepça '89 dhe KEK-u - Drenica. Të dielën përfundon kjo xhiro me

dy ndeshje shumë interesante ku Ballkani në Suharekë e pret Prishtinën, derisa Flamurtari në kryeqytet e pret Feronikelin. Të gjitha ndeshjet e kësaj xhiro fillojnë nga ora 14:00.



Solskjaeri konfirmohet zyrtarisht në stolin e Unitedit

MANCHESTER, 28 MARS - Ole Gunnar Solskjaer është zyrtarisht trajner me kohë të plotë i Manchester Unitedit. Klubi anglez e bëri të ditur këtë lajm nëpërmjet një komunikate për shtyp në faqen zyrtare. Trajneri norvegjez e mori drejtimin e Unitedit në muajin dhjetor, teksa u caktua si trajner i komanduar i "Djajve të Kuq" në vend të Jose Mourinhos që u

shkarkua. Kur Solskjaer e mori drejtimin e Unitedit, skuadra ishte në vendin e 6 në Premier Ligë dhe 11 pikë prapa skuadrës që kryesonte. Në 13 ndeshje të zhvilluara me norvegjezin në bankinë, Manchester Unitedi ka humbur vetëm një herë, atë me Arsenalin dhe tani është vetëm dy pikë larg "topçinjve" për zonën e Ligës së Kampionëve. Solskjaeri është trajneri i

parë i Manchester Unitedit që fiton gjashtë ndeshjet e tij të para në kampionat, duke thyer rekordin e Sir Matt Busby. Edhe në Evropë Unitedi po bën mjaft mirë pasi u kualifikua në çerekfinale të Ligës së Kampionëve, pasi eliminoi Paris Saint Germainin në Francë, teksa përmbysi humbjen 0-2 të pësuar në "Old Trafford".



Musolli: Jam gati për Partizanin, vetëm fitorja na mban në lojë për titullin

TIRANË, 28 MARS - Besar Musolli është gati për ta ndihmuar Kukësin me praninë e tij në fushë në këtë fund të sezonit. Mesfushori kosovar është rikuperuar plotësisht nga dëmtimi dhe tashmë është në dispozicion të trajnerit Ndreu duke filluar nga sfida e kësaj të premtje ndaj Partizanit që mund të vendosë edhe fatet e titullit kampion. Në një intervistë për "Supersport", Musolli ka folur për gjendjen e tij fizike dhe për sfidën e drejtpërdrejtë për titull ndaj Partizanit. "Ka një muaj e gjysmë që kam filluar të bëj stërvitje me grupin. Shyqyr Zotit gjithçka ka shkuar mirë. Ndihem 95% gati, patëm një miqësore ku u aktivizova për rreth 30 minuta dhe çdo gjë ishte mirë. Tani varet nga trajneri nëse do të aktivizojë ose jo", ka deklaruar Musolli. "Partizani? Normalisht deri tani ka bërë shumë pasi dhe



fakti që është nëntë pikë larg nesh tregon se ka bërë shumë mirë. Mendoj se kjo ndeshje është një finale për ne sepse po na mundën ose barazuan mendoj se janë zyrtarisht kampionë", ka deklaruar Musolli. Mesfushori nga Kosova foli edhe për fushën e stadiumit "Loro Boriçi", duke thënë se

ajo i ka sjellë shumë herë fat skuadrës së Kukësit. "E para mendoj se fusha e 'Loro Boriçi' të ndihmon të luash futboll pasi, siç dihet, fusha e Kamzës nuk është edhe aq e mirë. Ne kemi zhvilluar ndeshje të tjera atje që na kanë sjellë fat. Shpresoj që edhe kjo të sjellë fat për ne", ka deklaruar Musolli.

Golden State 'leksion' Memphisit, fitojnë edhe Oklahoma dhe Portlandi

MEMPHIS, 28 MARS - Kampionët e Golden States fituan 118-103 ndaj Memphisit në fushën e këtij të fundit, ndeshje e dominuar nga basketbollistët e Warriorsit, me Durantin dhe Curryn që realizuan nga 28 pikë secili. Për vendësit u dallua Valanciunas, që realizoi 27 pikë e 13 rebounde. Tjetër humbje për Lakersin, që u mund 115-100 nga Utah Jazzi, që hedhi një hap të rëndësishëm për "play-off". Gobert realizoi 22 pikë e 11 rebounde, lider në fushë për vendësit, duke i bërë të pavlefshme 21 pikët e Kuzmas për kalifornianët, raporton "Telesport". Vijon të duelojë për një vend në "play-off" ekipi i Oklahomës, që mundi 107-99 Indianan, ndeshje e dominuar nga basketbollistët e Thunderit. George realizoi 31 pikë, mbështetur edhe nga Adams me 25 pikë e 12



rebounde. Ndërsa Russell Westbrook realizoi një "triple double", me 17 pikë, 11 rebounde e 12 asistime. Ekipi i Portlandit, falë 20 pikëve të Seth Curryt, mundi 118-98 Chicagon, ndërsa skuadra e Washingtonit triumfoi 124-121 ndaj Phoenixit, ndeshje ku diferencën e bënë Beal e Parker, me nga 28 pikë secili.

REZULTATET

Chicago - Portland 98-118

Memphis - Golden State 103-118

Oklahoma - Indiana 107-99

Phoenix - Washington 121-124

Utah Jazz - Lakers 115-100

SHKURT

Figo: Ramosi e meriton 'Topin e Artë'

Luka Modriqi e fitoi "Topin e Artë" për vitin 2018 pasi e ndihmoi Kroacinë drejt arritjes në finale të Kupës së Botës, por Luis Figo beson se Sergio Ramosi gjithashtu meriton ta fitojë çmimin e lartë individual. Kapiteni i Real Madridit fitoi tre trofe të Ligës së Kampionëve radhazi, por pati një fushatë zhgënjyese me Spanjën në Kupën e Botës në Rusi. "Është e qartë se Sergio Ramosi meriton ta fitojë 'Topin e Artë'", ka thënë Figo në një intervistë për gazetën "Marca". "Duke qenë një mbrojtës, është pothuajse si të jesh portier, është shumë më e vështirë për ta fituar çmimin, por Cannavaro e ka arritur atë. Kjo varet nga çastet dhe trofetë brenda vitit, por vetëm për cilësinë, është e qartë se Ramos duhet ta fitojë", ka shtuar Figo.

Transferimi i Griezmannit në Barcelonë, punë e kryer

Antoine Griezmann u përfol shumë sezonin e kaluar për një kalim te Barcelona, por në fund sulmuesi vendosi ta rinovojë kontratën e tij me Atletico e Madridit. Kur ka kaluar gati një vit që nga ajo kohë, spekulimet për një transferim në Katalonjë ende nuk janë ndalur. Madje, së fundmi, gjiganti francez "RMC Sport" zbulon se 27-vjeçari ka gjetur marrëveshjen me klubin blaugrana dhe në fund të sezonit do ta veshë fanellën e Barcelonës. Është pikërisht Zheron Roten, ish-futbollisti i PSG-së, i cili ka thënë për "RMC Sport" se transferimi i Griezmannit në "Camp Nou" është diçka e kryer. Në rast se diçka e tillë konkretizohet, atëherë pa dyshim do të ishte një ndër lëvizjet më të mëdha të merkatos, me Barçën që do të kryente një përforsim mjaft të rëndësishëm.

Liverpooli refuzon Realin për Manen

Sulmuesi senegalez, Sadio Mane, është dëshirë e skuadrës së Real Madridit, që tani për trajner ka Zinedine Zidanen. Lajme për transferimin e Manes te Real ka pasur edhe vitin e kaluar, para se Zidane të largohej nga Real Madridi. Kthimi i francezit te 'Los Blancos' ka kthyer interesimin e tyre për Manen. Për këtë interesim tashmë është informuar edhe Liverpooli. Por, sipas 'The Mirror', Liverpooli nuk do ta lejojë largimin e Manes, pasi e konsideron lojtar shumë të rëndësishëm për klubin.

Bayerni nuk ndalet, kërkon edhe De Ligtin

Bayern Munchen është pa dyshim klubi më aktiv në merkato, edhe pse ende duhet kohë që të hapet afati kalimtar. Gjiganti gjerman ka siguruar shërbimet e Pavardit dhe Lukas Hernandez për sezonin e ardhshëm, me një shumë totale prej 115 milionë eurosh të shpenzuar për dy kampionët e Botës. Pavarësisht prej nënshkrimit me dy mbrojtës, "bavarezët" duket se nuk kanë ndërmend të ndalen me kaq për sa i përket prapavijës. Ditën e sotme në media po qarkullon lajmi se drejtues të klubit gjerman kanë bërë gati një ofertë për Matthijs de Ligt, që besohet të jetë diçka më shumë se 70 milionë euro. Sipas medieve, paratë nuk do të jenë problem për Bayernin këtë merkato dhe se futja në garë për De Ligt lidhet me faktin se Jerome Boateng dhe Mats Hummels shihen si e kaluar për klubin, me Niklas Sule që pritet të jetë diga kryesore në mbrojtje. Në garë për De Ligt janë edhe Barcelona apo dhe Juventus, por me klubin blaugrana që duket më favorit, kjo edhe për shkak të marrëdhënies së mirë që ka me Ajaxin edhe pas nënshkrimit me Frenki De Jong.

Forlani: Unitedi mund ta eliminojë Barçën

Diego Forlan beson se ish-skuadra e tij, Manchester United, mund ta eliminojë Barcelonën nga Liga e Kampionëve. Uruguaiiani, tani 39 vjeç, kaloi dy vjet te Djajtë e Kuq para se të kalonte shtatë vjet në futbollin spanjoll te skuadra e Villarrealit dhe Atletico Madridit. "Ndeshja ndaj Barcelonës do të jetë një lojë shumë ndryshe për Unitedin. Ata janë një ekip shumë i mirë dhe në futboll nuk e dini se çfarë do të ndodhë. Por ata kanë një lojë vërtet të mirë para, një ndeshje të vështirë. Unitedi ka një ekip shumë të mirë me lojtarë të mirë dhe nëse ata bëjnë mirë në shtëpi, atëherë ata kanë një mundësi reale për ta eliminuar Barcelonën", ka thënë Forlan.



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

Specific Procurement Notice

Open Air Quality Data Workshop

Ref No: MFK /2019/ CQS / No. 008

The Government of Kosovo has received grant funding of UD\$49,000,000.00 (Forty-Nine Million United States Dollars) from the Millennium Challenge Corporation (MCC) of the United States Government to support Kosovo through a Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The Millennium Foundation of Kosovo (MFK), the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, intends to apply parts of the proceeds of the funds to payments for Contracts for Goods, Works and Services.

To support this project MFK is seeking for qualified and experienced legally constituted firms to submit Qualifications Documents for the Consultant Services: **Open Air Quality Data Workshop** to support the project.

Applications submission deadline: 11 April 2019, 16:00 Kosovo Time (CET).

Interested eligible consultant may refer to the other relevant documents at:
<https://millenniumkosovo.org>



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta -
Ministry of Culture, Youth & Sports

DEPARTAMENTI I FINANCEVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF
FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH
USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA
LJUDSKIH IZVORA

NJOFTIM PËR ZGJATJEN E PRANIMIT TË APLIKACIONEVE

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbështetur në Procedurat e Rekrutimit, njofton se për të arritur pranimin e balancuar të aplikacioneve nga aspekti gjinor dhe etnik zgjat edhe për 7 ditë kalendarike pranimin e aplikacioneve për pozitën;

Zyrtar per Administrimin e Teknologjise Informative

OBAVEŠTENJE O PRODUŽENJU PRIMANJA APLIKACIJA

Ministarstvo Kulture Omladine i Sporta oslanjajući se o proceduri primanja, obaveštava vas da u cilju dostizanja za balansni prijem aplikacija sa polnog i etničkog aspekta , nastavlja se za još 7 kalendarskih dana primanje aplikacija za sledeće poziciju;

Sluzbenik za Upravljanje Informativne Tehnologije

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, kompania "Abi Likaj" Sh.p.k.Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e betonit, gurëthyesin dhe seperacionin në Krajë, Komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.04.2019 në ora 10:00 në në Landovice perkatesisht te autoservis-Bife Leutrimi krahu i majte i rruges ne drejtim te gjakoves, do të organizohet debat publik nga kompania "Abi Likaj" Sh.p.k.Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e betonit, gurëthyesin dhe seperacionin në Krajë, Komuna e Prizrenit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Njoftimi për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Falk Konica"- Celinë
Komuna: Rahovec
Data: 29.03.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/093 - ESIP/SDG/093-CS/1.2	Trajnimit i mësimdhënësve për përdorimin e TIK-ut

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollën "Falk Konica"- Celinë-Rahovec.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulentëve të nevojshme:

- Trajnim i mësimdhënësve për TIK

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)


Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përgjedyhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përgjedyhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).


Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: "Falk Konica"- Celinë-Rahovec, më së largu deri më 8.04. 2019.

Firmat e interesuara të konsulentëve mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Ymer Fazliu
Telefoni: 044 200 832
E-maili: ymerfazliu@hotmail.com, manush.f@hotmail.com




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KONVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 02-111/01-00/17969/19
Data 28 03 2019



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit të Komunës
Udhëheqësi i Personelit/Rukovodilac Personala/Head of Personnel

Nr. 111/01-00/17969/19
Skenderaj, më 28 Mars 2019.

Udhëheqësi i Personelit, duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11, paragrafi 1 dhe 2, nenin 12 paragrafi 3, neni 18, paragrafi 1, neni 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Shërbimin Civil nr.03/L-149, dhe Rregulloren nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në SHC si dhe pas autorizimit për shpalljen e konkursit nga MAP përmes SIMBNJ nga DASHC për pozitën e lira për një, Zyrtar Ligjor 2 LI/060 / JP00037916-, më 28 Mars 2019, vendosi të shpallë këtë:

KONKURS

Për plotësimin e një(1) vendi të lirë të punës në organet e Administratës të Komunës së Skenderajt.

Emri i Institucionit: Komuna e Skenderajt—Drejtoria për Arsim
Pozita e punës: Zyrtar Ligjor 2
Numri i Ekzekutuesve: 1
Kodi Buxhetor: 16323.
Kategoria funksionale: Profesional 2
Grada e vendit të punës: Koeficienti 7
Lloji i vendit të punës: I karrierës, më orar të plotë(40)orë.
Raporti: në Drejtori për Arsim
Vend ndodhja: Drejtoria për Arsim Komuna Skenderaj.

-Përkrahimi i detyrave të punës: Harton akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtarie dhe institucionit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, siguron përputhshmërinë e projektligjeve dhe akteve tjera nënligjore me legjislacionin në fuqi në Kosovë, kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të është sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik si dhe të jenë identike në të tri gjuhët zyrtare, bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikëqyrësi dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim, sipas kërkesës dhe sipas udhëzimeve të nivelit më të lartë jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projekt marrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlihen me fushën e legjislacionit, kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kualifikimi: Përgatitja profesionale: Diplome Universitare se paku 2 vite përvojë pune


- Përveç kushteve të parapara me ligj, kandidati duhet t'i plotësojë kushtet si në vijim:
- Një CV të shkurtër.
- Të këtë shkathësi dhe aftësi profesionale për këtë vend pune.
- Kandidati duhet të jetë i gatshëm të punojë nën presion dhe në shoqëri multietnike.
- Shkathësi dhe aftësi të mira komunikimi.
- Njohja e gjuhëve zyrtare.
- Kohëzgjatja e punës provuese 12 muaj, në bazë të Rregullores të MAP/DASHC nr. 02/2011.


Të interesuarit për këtë vend pune, aplikacionit duhet t'ia bashkëngesin këto dokumente:

- Diplome Universitare –Fakulteti Juridik se paku 2 vite përvojë.
- Dëshmi për përvojën e punës.
- Certifikata e lindjes.
- Kopjen e letërnjoftimit të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës.
- Certifikatën që nuk jeni të dënuar dhe nën hetime nga Gjykata.
- Kandidati/ja që pranohet në vendin e punës duhet të sjellë certifikatën mjekësore .


“Shërbimi Civil i Kosovës është në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës, i cili i mirëpret të gjitha aplikacionet nga meshkujt dhe femrat të të gjitha komuniteteve të Kosovës” Aplikacionet mund të merren në Zyrën Pritëse (QSHQ) të Komunës së Skenderajt. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse (QSHQ) të Komunës së Skenderaj, në kopje dhe mbetet në arkiv nuk kthehet, konkursi është i hapur në afat prej 15 ditësh, që nga dita e shpalljes së këtij konkursi në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditshme dhe në web-faqen e Komunës. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që vijnë pas afatit të konkursit ,nuk do të shqyrtohen. Konkursi do të shpallet në të dy gjuhët.

Udhëheqësi i Personelit
Armend Gruda






Republika Kosova



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KONVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 02-111/01-00/17969/19
Data 28 03 2019



Opština Skenderaj

Rukovodilac personala

Br. 111
Skenderaj, 28 marta 2019

Rukovodilac personala , shodno çlanu 3 stav 2, çlanu 11 stavovima 1 i 2 çlanu 12 stav 3, çlanu 18 stav 1, çlanu 20 stavovima 1 i 2 Zakona o državnoj službi br. 03 / L-149 i Uredbe br. 02/2010 za procedure zapošljavanja RIK-a, kao i nakon odobrenja za raspisivanje natječaja od strane MAP-a putem DKP-a DCSA-a za slobodna radna mjesta za jednog pravni službenik. odlučio je da proglasi sledeće:

KONKURS

Da popuni 1 slobodnih mesta u organima Administracije opštine Skenderaj

Naziv institucije:	Opština Skenderaj - Direkcija za obrazovanje
Radno mesto:	pravni službenik 2
Broj rukovodilaca:	1
Budžetski kod:	16323
Funkcionalna kategorija:	Profesional 2
Rangiranje na radnom mjestu:	Koeficient 7
Tip radnog mesta:	karijera, puno radno vrijeme (40) sati.
Izveštava:	načelniku Inspektorata, Direkcija za obrazovanje
Lokacije:	Direkcija za obrazovanje, opština Skenderaj

Opis radnih zadataka: izrađuje normative akte kao i druge pravne akte koji proizilaze iz aktivnosti institucije na osnovu procedura utvrđenih zakonodavstvom na snazi, osigurava usklađenost nacrta zakona i drugih podzakonskih akata sa važećim zakonodavstvom Kosova, brine se da sadržaj i forma normativnog akta da budu što tačniji, jezički i tehnički mogući i da budu identični na sva tri službena jezika, uključujući istraživanje i analizu informacija o temama koje je postavio nadzornik i identifikovanje opcija ili pitanja za pregled, prema zahtevu i uputstvima najvišeg nivoa, daje pravne opcije i nacrte nacrta sporazuma, nacrta odluka i drugih nacrta akata, saraduje i komunicira sa drugim jedinicama unutar i izvan ustanove za poslove iz oblasti zakonodavstva, obavlja druge poslove u skladu sa svrhom radnog mjesta koje nadzornik može povremeno zahtijevati.

Kualifikacija: Profesionalna priprema: Univerzitetska Diploma, najmanje 2 godine radnog staža

- Pored uslova predviđenih zakonom, kandidat mora ispuniti sljedeće uslove:
- Kratak CV
- Imati vještine i profesionalne vještine za ovaj posao.
- Kandidat treba da bude spreman da radi pod pritiskom iu multietničkom društvu.
- vještine i dobre komunikacijske sposobnosti.
- poznavanje zvaničnih jezika.
- Trajanje probnog rada 12 meseci, na osnovu radne grupe MPA / DCSA br. 02/2011.


Kandidati za ovaj posao trebaju priložiti ove dokumente:

- Univerzitetska Diploma- Pravni fakultet koji je prošao 3 godine radnog staža.
- Svedočenje za radno iskustvo.
- Kopija Lične Karte izdatog od strane Ministarstva unutrašnjih poslova Republike Kosova.
- Potvrda da niste osuđeni i pod istragom Suda.
- Kandidat koji je zapošljen treba doneti lekarsko uverenje.

“Civilna Sluzba Kosova je na usluzi svih stanovnika Kosova i poželjno očekuje aplikacije od muskaraca i žena od svih Zajednica Kosova”

Aplikacije se mogu dobiti u CUG-u (Arhivi) br. 1, u prostornjama opštine Skenderaj.
Dokumentacija se predaje u CUG-u, SO Skenderaj, u roku od 15 dana od dana objavljivanja ovog konkursa na javnim srdstvima informisanja. Nekompletirana dokumentacija i ona koja dolazi posle roka konkursa neće se razmatrati. Predata dokumentacija neće se vratiti strankama, jedno kopije ostaje u Arhivi za dalji postupak. Konkurs se objavlja na oba jezika.

Rukovodilac Personala:
Armend Gruda, s.r.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Gllgoc
Zyra e Personelit

01Nr. MM1-16801 dt. 28/03/2019

Bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11 paragrafi 1, neni 12 paragrafi 3, neni 18 paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Gllgoc/Drenas, shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për pozitën : **Zyrtar i Personelit 1**

Emri i institucionit rekrutues:	Komuna Drenas/Gllgoc
Nr. references:	RN00004592
Pozita e punës:	Zyrtar i Personelit 1
Institucioni:	Zyra e Kryetarit
Divizioni/njësia:	Zyra e Personelit
Lloji i pozitës:	1 Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës:	Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit:	Menagjeri i Personelit
Kategoria Funksionale –Grada	Niveli Profesional, grada 10, Koefficienti 6
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit:	Po
Procedura e Aplikimit:	1 Jashtëm
Numri i kërkuar:	1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit:	1 përhershëm

Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave: Niveli Profesional, grada 10, Koefficienti 6, Zyra e Kryetarit, Komuna Drenas.

Detyrat Kryesore:

- Kujdeset që proceset e rekrutimit të zbatohen në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil;
- Kujdeset që shpalljet për publikim e vendeve të lira të punës të jenë në pajtim me standardet e përcaktuara me rregulloret përkatëse;
- Pranon, regjistron dhe verifikon aplikacionet e kandidatëve të cilët kanë aplikuar për pozita të lira të punës;
- Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për komisionin lidhur me procesin e rekrutimit;
- Siguron që listat e pagave të stafit të institucionit janë përgatitur në pajtim me procedurat ligjore;
- Përditëson dosjet e personelit me të dhëna dhe dokumente relevante dhe kujdeset që të gjitha llojet e pushimeve të stafit janë proceduar në pajtim me procedurat ligjore;
- Përgjegjës për raportim të punës të përgjegjësi kompetent për dhënie e shënimeve dhe raporteve lidhur me të gjitha kërkesat e pranuar dhe për parregullsi eventuale;
- Kryen edhe detyra tjera në pajtim me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat me arsye mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kualifikimi i nevojshëm arsimor: (aftësitë, përvoja si dhe shkallësitë tjera që kërkojnë për këtë vend të punës):
Diplomë universitare pa përvojë ose shkollë të lartë dhe së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale;
Fakulteti Juridik, Administratë Publike.

Njohuri profesionale specifike në fushën e burimeve njerëzore;
Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështjet teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
Aftësi për të organizuar punën e vet dhe për të koordinuar stafin e nivelit administrativ;
Shkathtësi hulumtuese, analitike dhe të vlerësimit të informacionit;
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:
Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës, Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.
Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje të noterizuara dhe nuk kthehen.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen.
Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: kopje e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, certifikata e kandidatit që nuk është nën hetime, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kritereve të konkursit.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, që nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditëshme dhe në web-faqen e Komunës, nga data **28/03/2019 deri më 11/04/2019**, për pozitën e cukur më lart.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes faqesë së komunës dhe shpalljes në hyrje të komunës.

U.D. Udhëheqëse e Personelit
Haniushahe Shabani

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Gllgoc
Zyra e Personelit

01Nr. MM1-16801 dt. 28/03/2019

Bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11 paragrafi 1, neni 12 paragrafi 3, neni 18 paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Gllgoc/Drenas, shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për pozitën : **Zyrtar për Shërbime Sociale 2**

Emri i institucionit rekrutues:	Komuna Drenas/Gllgoc
Nr. references:	RN00004593
Pozita e punës:	Zyrtar për Shërbime Sociale 2
Institucioni:	Qendra për Punë Sociale
Divizioni/njësia:	Spektori i Shërbimeve Sociale
Lloji i pozitës:	1 Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës:	Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit:	Shefi i Sektorit
Kategoria Funksionale –Grada	Niveli Profesional, grada 10, Koefficienti 6
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit:	Po
Procedura e Aplikimit:	1 Jashtëm
Numri i kërkuar:	1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit:	1 përhershëm

Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave: Niveli Profesional, grada 9, Koefficienti 7.5, Qendra për Punë Sociale, Komuna Drenas.

Detyrat Kryesore:

- Zbatimi i Ligjit Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë si dhe udhëzimeve implementuese;
- Azhurimi i lëndëve sipas afateve ligjore;
- Procedura e verifikimit, riveifikimit në teren;
- Respektimi i afateve për bazën e të dhënave;
- Sistemimi i dosjeve aktive dhe pasive;
- Raportimi javor të shefi i SNS;
- Përgatitja e lëndëve për KM;
- Kryerja edhe e punëve tjera sipas urdhërit të Drejtorit të QPS;

Kualifikimi i nevojshëm arsimor: (aftësitë, përvoja si dhe shkallësitë tjera që kërkojnë për këtë vend të punës):
Diplomë universitare , 2 vite përvojë pune profesionale;
Fakulteti Filozofik- Drejtimi Sociologji, Fakulteti Juridik, Administratë Publike.

Njohje kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
Aftësi komunikimi me kolegët, palët, palët, eprorët dhe rrethin;
Aftësi për përbushjen e detyrave dhe punëve nën presion;

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:
Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës, Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.
Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje të noterizuara dhe nuk kthehen.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen.
Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: kopje e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, certifikata e kandidatit që nuk është nën hetime, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kritereve të konkursit.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, që nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditëshme dhe në web-faqen e Komunës, nga data **28/03/2019 deri më 11/04/2019**, për pozitën e cukur më lart.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes faqesë së komunës dhe shpalljes në hyrje të komunës.

U.D. Udhëheqëse e Personelit
Haniushahe Shabani

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Gllgoc
Zyra e Personelit

01Nr. MM1-16801 dt. 28/03/2019

Bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11 paragrafi 1, neni 12 paragrafi 3, neni 18 paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Gllgoc/Drenas, shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për pozitën : **Zyrtar për Listat e Pagave për Arsim**

Emri i institucionit rekrutues:	Komuna Drenas/Gllgoc
Nr. references:	RN00004594
Pozita e punës:	Zyrtar për Listat e Pagave për Arsim
Institucioni:	Drejtoria Komunale e Arsimit
Divizioni/njësia:	Spektori i Arsimit
Lloji i pozitës:	1 Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës:	Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit:	Drejtori i Drejtorisë Komunale
Kategoria Funksionale –Grada	Niveli Profesional, grada 10, Koefficienti 6
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit:	Po
Procedura e Aplikimit:	1 Jashtëm
Numri i kërkuar:	1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit:	1 përhershëm

Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave: Niveli Profesional, grada 10, Koefficienti 6, Drejtoria Komunale e Arsimit, Komuna Drenas.

Detyrat Kryesore:

- Sistemon dhe procedon materialin lidhur me pagat në bazën e të dhënave të sistemit të pagave;
- Përgatitjen e formularëve për ndryshimet në listat e pagave dhe dërgimin fizik të tyre në Divizionin e sistemit të Pagave në MEF;
- Arkivimin dhe sisteminin e lëndëve të Drejtoriatit për Arsim në arkiv të Komunës;
- Asistimin në regjistrimin e aplikacioneve të mësimdhënësve, stafit tjetër për kandidatët që aplikojnë në institucionet arsimore;
- Sistemon dosjet e personelit të shkollave, si kontratat, diplomat, vërtetimet e përvojave të punës, certifikatat e trajnimeve etj ;
- Mbajtjen e procesverbalit në mbledhjen më Drejtor të Institucioneve arsimore, të komisioneve rekrutuese për institucionet arsimore;

Kualifikimi i nevojshëm arsimor: (aftësitë, përvoja si dhe shkallësitë tjera që kërkojnë për këtë vend të punës):
Diplomë universitare pa përvojë ose shkollë të lartë dhe së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale;
Fakulteti Juridik, Administratë Publike, Ekonomik.

Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështjet teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
Shkathtësi hulumtuese, analitike dhe të vlerësimit të informacionit;
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:
Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës, Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.
Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje të noterizuara dhe nuk kthehen.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen.
Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: kopje e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, certifikata e kandidatit që nuk është nën hetime, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kritereve të konkursit.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, që nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditëshme dhe në web-faqen e Komunës, nga data **28/03/2019 deri më 11/04/2019**, për pozitën e cukur më lart.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes faqesë së komunës dhe shpalljes në hyrje të komunës.

U.D. Udhëheqëse e Personelit
Haniushahe Shabani

